

**LUFTIMI I KORRUPSIONIT
NË VENDET E BALLKANIT
PERËNDIMOR DHE NË TURQI:
PRIORITETET PËR REFORMA**

Transparency International është një lëvizje globale, e cila ka një vizion: një botë ku qeveria, biznesi, shoqëria civile dhe njerëzit në jetën e tyre të përditshme janë të çliruar nga korrupsioni. Me më shumë se 100 degë anembanë botës dhe me sekretariat në Berlin, ne udhëheqim luftën kundër korrupsionit me qëllim që këtë vizion ta shndërrojmë në realitet.

www.transparency.org

Autor: Andy McDevitt

Project Coordinator: Giulia Sorbi

Design: Daniela Cristofori

© Fotografia e kopertinës: iStockphoto

Janë bërë të gjitha përpjekjet për të verifikuar saktësinë e informatave që përmban ky raport. Të gjitha informatat janë besuar si të sakta, duke filluar nga tetori i vitit 2016. Megjithatë, Transparency International nuk mund të pranojë përgjegjësi për pasojat e përdorimit të tij për qëllime të tjera apo në kontekste të tjera.

ISBN: 978-3-96076-032-0

Shtypur duke përdorur 100% letër të ricikluar.

Përveç kur shënohet ndryshe, ky punim është i licencuar sipas CC BY-ND 4.0

© Transparency International 2016. Disa të drejta janë të rezervuara

This publication has been produced with the assistance of the European Union.

The contents of this publication are the sole responsibility of Transparency International and can in no way be taken to reflect the views of the European Union.



The project is funded by the European Union

PËRMBAJTJA

Përmbledhje Ekzekutive	4
Rekomandimet Kyçe	6
Hyrje	8
Metodologjia Për Sistemin E Integritetit Kombëtar	8
Vështrim I Përgjithshëm Dhe Konteksti	8
Tiparet Kyçe Të Sistemeve Të Integritetit Kombëtar Në Vendet E Ballkanit Perëndimor Dhe Në Turqi	10
1. Drejtësi Dhe Zbatim I Dobët I Ligjit	13
2. Sisteme Politike Të Kapura	19
3. Media Dhe Shoqëri Civile Nën Kërcënim	23
ANEKS: Rekomandime Specifike Sipas Vendeve	26

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Që prej fillimit të viteve '90, me perspektiva gjithmonë e në rritje për integrim në Bashkimin Evropian, vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqia kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të zhvilluar dhe fuqizuar sistemet e tyre kundër korrupsionit. Megjithatë, përparimi ka qenë i ngadaltë dhe zbatimi i ligjeve dhe politikave mbetet shumë prapa asaj që parashikohet në letër.

Ky raport bazohet në gjetjet e hulumtimit të thelluar për përpjekjet kundër korrupsionit, i kryer nga degët dhe partnerët e Transparency International në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë (BdheH), Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Serbi dhe Turqi, midis viteve 2014 dhe 2015. Duke u përqendruar veçanërisht te drejtësia dhe sistemi i zbatimit të ligjit, sistemi politik dhe sektorët jo-shtetërorë, ky hulumtim vë në pah prirjet dhe sfidat e përbashkëta në të gjithë rajonin dhe iu ofron qeverive të këtyre vendeve një grup prioritetesh për reforma.

Një tipar konsistent te të shtatë vendet është dukuria e kapjes së shtetit, ku degët e fuqishme të ekzekutivit dhe partitë politike dominojnë të gjitha institucionet e tjera, krahas mungesës së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet aktorëve shtetërorë. Të dy këta faktorë e minojnë aftësinë e organeve gjoja të pavarura të gjyqësorit, të zbatimit të ligjit dhe të anti-korrupsionit për të ofruar mbikëqyrje kuptimplotë të veprimtarive qeveritare dhe për të hetuar me efikasitet dhe ndjekur penalisht rastet e korrupsionit. Në të njëjtën kohë, aktorëve jo-shtetërorë, në veçanti medias dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC), iu mungojnë kapaciteti dhe pavarësia e duhur për t'i bërë përgjegjëse qeveritë në mënyrë efektive dhe të vazhdueshme. Në një kontekst të fragmentimit të vazhdueshëm social dhe përçarjeve etnike dhe fetare, kjo krijon kushtet ideale për lulëzimin e favoritizmit dhe zbatimit të pabarabartë të ligjit. Rezultati përfundimtar është një gjendje ku ligjet dhe politikat kundër korrupsionit, ndonëse të mira në letër, zbatohen në mënyrë selektive, ndërkohë që korrupsioni në zyrat publike kryesisht mbetet pa u ndëshkuar.



Drejtësia dhe zbatimi i dobët i ligjit

Në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në Turqi, përgjegjësia për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit ndahet midis shumë organeve gjyqësore, të zbatimit të ligjit dhe të anti-korrupsionit. Fragmentimi i funksioneve ndëshkuese ndërmjet institucioneve nuk është problematik në vetvete, për sa kohë këto institucione mund të operojnë pa u ndikuar nga ndërhyrje politike të panevojshme dhe janë në gjendje të bashkëpunojnë dhe të koordinojnë veprimtaritë me efikasitet. Për fat të keq, përvoja në këtë rajon tregon se nuk ndodh kështu, gjë që i bën këto organe më të prekshme nga manipulimi dhe më pak të afta për të kryer funksionin e tyre. Në problemet kyçe bëjnë pjesë: mbivendosjet institucionale në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit (Kosovë, Serbi, Turqi), bashkëpunimi i kufizuar midis prokurorisë dhe policisë (Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, Serbi) dhe lufta e brendshme e vazhdueshme midis aktorëve kyç gjyqësorë dhe të zbatimit të ligjit (Shqipëri, BdheH). Rajoni vuan edhe nga ndërhyrjet politike të përhapura në emërimin, transferimin dhe heqjen e gjyqtarëve, prokurorëve dhe zyrtarëve policorë, si dhe nga ndërhyrjet e pajustificuara në operacionet e përditshme dhe proceset e vendimmarrjes të organeve të anti-korrupsionit dhe të gjyqësorit.

Për rrjedhojë, rajoni ka një historik shumë të dobët të ndjekjes penale të rasteve të korrupsionit, sidomos në radhët e zyrtarëve publikë të nivelit të lartë.

Edhe kur hetohen, këto raste shpeshherë pësojnë vonesa të gjata dhe shpeshherë përfundojnë në lirime apo rezultojnë në dënime të lehta apo jokonsistente (Shqipëri, BdheH, Mali i Zi, Serbi)¹. Aktakuzat shpeshherë shkruhen keq dhe hetohen në mënyrë të papërshtatshme, ndërkohë që prokurorët dhe gjyqtarët i kuptojnë keq rastet komplekse të korrupsionit (Shqipëri, Kosovë)².

Pavarësisht kësaj panorame të zymtë, janë bërë disa përpjekje të rëndësishme për të fuqizuar pavarësinë e gjyqësorit në rajon, gjë që dëshmon se aty ku ka vullnet politik, edhe reformat janë të mundshme. Mali i Zi, për shembull, ka integruar parimin e palëvizshmërisë së gjyqtarëve, ka vendosur limite për ndikimin politik në procesin e emërimit të gjyqtarëve dhe ka përmirësuar bashkëpunimin midis prokurorisë dhe policisë përmes ofrimit të themeleve për krijimin e një ekipi special hetimor kurdoherë që shihet e arsyeshme. Ndërkohë, në Kosovë Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial tashmë kanë diskrecion më të madh në hartimin dhe propozimin e buxheteve të tyre te Kuvendi, ndërkohë që gjyqësori ka një rol më të dukshëm në emërimin e anëtarëve në Këshillin Gjyqësor. Në vendet e tjera, reformat pozitive kanë ndeshur pengesa madje edhe janë zhbërë, sikurse ka ndodhur në rastin e humbjes së pavarësisë nga politika të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial të B&H-së gjatë dhjetë viteve të fundit.

1 Shihni vlerësimet e SIK-ut për Shqipërinë, Bosnjën & Hercegovinën, Malin e Zi dhe Serbinë

2 Shihni vlerësimet e SIK-ut për Shqipërinë dhe Kosovën



Sisteme politike të kapura

Dobësia në zbatimin e ligjit në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në Turqi mund t'i atribuohet në pjesën më të madhe sistemeve politike të kapura, të cilat janë zhvilluar gjatë dekadave të fundit. Aktorët politikë kanë ndikim të madh pothuaj në të gjitha fushat e jetës publike dhe shpesh kanë lidhje të ngushta me biznesmenë të pasur privatë dhe rrjete të krimit të organizuar, gjë që minon shtetin e së drejtës. Shembujt e manipulimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të sistemit politik janë të shumtë në rajon, duke përfshirë pretendimet për përpjekje për blerje votash (B&H, Mal të Zi), manipulim të mbulimit mediatik lidhur me kundërshtarët politikë (B&H, Maqedoni, Mal i Zi, Serbi, Turqi), pushime nga puna të nëpunësve civilë që nuk kanë lidhje me elitën që është në pushtet (Maqedoni), shpërbërje e partive opozitare duke marrë për bazë sigurinë shtetërore (Turqi), ofrim i ndihmës së kufizuar shtetërore partive opozitare më të vogla (Mali i Zi, Turqi), shpërdorim i burimeve publike për qëllime elektorale (Mali i Zi, Serbia) dhe kontroll i ndërmarrjeve shtetërore nga partia politike (të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor).

Kjo situatë përkeqësohet nga monitorimi i dobët i partive politike dhe i transparencës së kufizuar të tyre, gjë që do të thotë se shkeljet e rregulloreve të zgjedhjeve dhe fushatave nuk dënohen pothuaj asnjëherë. Një element i dobët e i përbashkët që i lidh të gjitha sistemet zgjedhore në rajon janë organet e administrimit të zgjedhjeve, të cilat operojnë në pesë nga shtatë vendet që mbulohen në këtë punim dhe që vazhdimisht kanë performancë të dobët krahasuar me institucionet e tjera. Mes të tjerash, kjo mund të ndodhë për shkak të burimeve të pamjaftueshme që kanë këto organe, fragmentimit institucional, mandateve të kufizuara, por edhe politizimit. Një përjashtim i dukshëm është Serbia, e cila ka pasur përmirësim të konsiderueshëm legjislativ lidhur me transparencën e informatave financiare të partive politike gjatë pesë viteve të fundit dhe një përmirësim në mbikëqyrjen financiare të partive politike në praktikë. Megjithatë, këto përmirësime nuk kanë çuar ende në rritjen e besimit të publikut se raportet financiare të partive politike janë gjithëpërfshirëse.

Në tërësi, mund të mos jetë e habitshme që partitë politike shihen nga qytetarët si disa prej institucioneve më të korruptuara, ku pothuaj tre të katërtat e qytetarëve në rajon i konsiderojnë ato si të korruptuara ose jashtëzakonisht të korruptuara.



Media dhe shoqëria civile nën kërcënim

Në mungesë të llogaridhënies së fuqishme horizontale dhe mekanizmave funksionalë të zbatimit të ligjit, është edhe më vendimtare që aktorët jo-shtetërorë të kenë si kapacitetin, ashtu edhe lirinë për t'iu kërkuar llogari aktorëve politikë. Megjithatë, të dyja, si media, ashtu edhe shoqëria civile, vuajnë nga forma të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të presionit në të gjithë rajonin, duke përfshirë kërcënime fizike dhe sulme (Shqipëri, B&H, Maqedoni, Mal të Zi, Serbi, Turqi); fushata njollosjeje dhe padi për shpifje (Shqipëri, B&H, Maqedoni, Serbi); përdorim të reklamave qeveritare apo reklamave të partive politike për të financuar mediat që janë pro qeverisë, nga njëra anë (B&H, Maqedoni) dhe përdorim të inspektimeve tatimore dhe zbatim të pabarabartë të ligjit për të kërcënuar mediat që janë kritike ndaj qeverisë, në anën tjetër (B&H, Maqedoni, Turqi); përdorim të legjisllacionit kundër terrorizmit për të censuruar dhe ndjekur penalisht gazetarë dhe aktivistë (Turqi); dhe kooptimi i OSHC-ve për të promovuar interesat e qeverisë (Shqipëri, Maqedoni, Serbi).

Lidhur me median në veçanti, situata është më kritike në Turqi, ku së fundmi ka pasur burgosje të gazetarëve mbi bazën e akuzave të rreme, kufizime të shërbimit të internetit, kufizime për gazetarët e huaj, dhunë ndaj personelit mediatik dhe në ambiente mediatike dhe ndryshime të menjëhershme të rregulloreve për mediat. Megjithatë, sektori i medias në të gjitha vendet karakterizohet nga kontrolli i rreptë i qeverisë dhe ndërhyrje të jashtme dhe vetë-çensurim, të cilat e minojnë aftësinë e medias për të vepruar si rojtare (watchdog) e pavarur dhe e paanshme.

REKOMANDIME KYÇE

Për të adresuar dobësitë e identifikuara në këtë raport, vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqia duhet të ndërmarrin urgjentisht hapa për të zbatuar një numër prioritetesh për reformën, sikurse paraqiten më poshtë. Megjithatë, për sa kohë ata që keqpërdorin pozitën e tyre të pushtetit mbeten të pandëshkuar dhe për sa kohë ekziston një pandëshkueshmëri e përgjithshme për veprimet e tyre, nuk do të ekzistojë besimi në sistemin ligjor dhe nuk do të ketë mbështetje popullore për reforma. Është po aq vendimtare që të sigurohet që reformat pozitive të arritura deri më tani të mos zhbëhen e kthehen mbrapsht, sikurse ka ndodhur shpesh në këtë rajon. Edhe Bashkimi Evropian duhet të luajë një rol kritik në përkrahjen e qeverive kombëtare në këto përpjekje për reforma, si pjesë të procesit të anëtarësimit në BE.

Në aneksin e këtij raporti paraqiten në hollësi veprimet e përzgjedhura dhe specifike sipas vendeve, ndërkohë që lista gjithëpërfshirëse e rekomandimeve specifike sipas vendeve mund të gjendet në secilin prej shtatë raporteve të vlerësimit të Sistemit të Integritetit Kombëtar (shihni pjesën e metodologjisë më poshtë).



Drejtësia dhe zbatimi i ligjit

- Të zvogëlohet ndikimi i ekzekutivit mbi gjyqësorin dhe prokuroritë, duke siguruar sisteme transparente dhe më objektive për emërimin, transferimin dhe largimin nga puna të gjyqtarëve dhe prokurorëve.
- Të zvogëlohet politizimi dhe të fuqizohet profesionalizimi i policisë përmes zbatimit të sanksioneve të rrepta mbi anëtarët e forcave policore të cilët përfshihen në veprimtari politike gjatë kryerjes së detyrave të tyre dhe përmes sigurimit të emërimit mbi bazën e meritave të personelit policor.
- Të forcohet bashkëpunimi midis organeve përgjegjëse për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit dhe të përmirësohet cilësia dhe ndarja e informatave lidhur me ndjekjen penale të kundërvajtjeve të korrupsionit.
- Të minimizohen vonesat në procedimin e rasteve të korrupsionit dhe të jepen arsytetime transparente për vendimet për mos-ndjekje penale.



Sistemi politik

- Të përmirësohet transparencja e financave të partive politike, duke përfshirë publikimin e plotë të të ardhurave dhe shpenzimeve të partive.
- Të zhvillohet një mbikëqyrje më e fuqishme dhe më e koordinuar e partive politike dhe financave gjatë fushatave dhe për aktivitete, dhe të sigurohet që shkelja e rregulloreve të zgjedhjeve dhe të fushatave të ndëshkohet në mënyrë konsistente.
- Të zbatohen ndëshkime të rrepta për shpërdorimin e burimeve publike për fushata zgjedhore.
- Të sigurohet integriteti i personave që kandidojnë për poste politike, për shembull përmes krijimit të mekanizmit të verifikimit të së shkuarës së kandidatëve dhe përjashtimit të atyre ndaj të cilëve janë ngritur akuza penale.



Media dhe shoqëria civile

- Të hetohen pa vonesa të gjitha pretendimet për kërcënime dhe dhunë ndaj përfaqësuesve të medias dhe të shoqërisë civile dhe të zbatohen dënime të rrepta kur provohet se këto pretendime janë të bazuara.
- Të sigurohet transparencë e plotë në aspektin e pronësisë së medias dhe të financimit të organizatave të shoqërisë civile.
- Të sigurohen procedura të drejta dhe transparente për alokimin e subvencioneve shtetërore dhe përjashtimeve nga taksat për organizatat e shoqërisë civile dhe mediat dhe të krijohen rregulla të qarta për reklamat e sponsorizuara nga shteti në media.
- Të sigurohet rregullimi efektiv dhe apolitik i medias dhe organizatave të shoqërisë civile.

HYRJE

Metodologjia për Sistemin e Integritetit Kombëtar⁴

Ky raport mbështetet në gjetjet e shtatë vlerësimeve të Sistemit të Integritetit Kombëtar të realizuara nga degët dhe partnerët e Transparency International në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Serbi dhe Turqi midis viteve 2014 dhe 2015 si pjesë e një projekti të financuar nga Komisioni Evropian, i cili për qëllim ka përmirësimin e qeverisjes së mirë në vendet që kërkojnë të anëtarësohen në BE përmes uljes së korrupsionit. Qasja e vlerësimit të Sistemit të Integritetit Kombëtar përbën një kornizë për të analizuar qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e institucioneve të një vendi në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Kur institucionet dhe sektorët që përbëjnë Sistemin e Integritetit Kombëtar punojnë së bashku në mënyrë efektive, ata bëjnë të mundur që sistemi kundër korrupsionit të funksionojë normalisht. Kur një apo më shumë institucione janë të dobëta, atëherë shfaqen plasaritje të cilat bëjnë që korrupsioni të depërtojë në sistem.

Në përgjithësi Sistemi i Integritetit Kombëtar vlerësohet se përbëhet nga këto institucione: ligjvënësi, ekzekutivi, gjyqësori, sektori publik, agjencitë e zbatimit të ligjit, organi i menaxhimit të zgjedhjeve, avokati i popullit, institucioni i lartë i auditimit, agjencitë kundër korrupsionit, partitë politike, media, shoqëria civile dhe biznesi. Për këtë hulumtim, prokuroria publike është vlerësuar në mënyrë të veçantë nga gjyqësori/agjencitë e zbatimit të ligjit, ndërkohë që janë përfshirë edhe ndërmarrjet shtetërore.

Secili prej institucioneve dhe sektorëve të përfshirë në Sistemin e Integritetit Kombëtar vlerësohet në raport me tri dimensione të cilat janë thelbësore për qëndrueshmërinë e tij për parandalimin e korrupsionit:

- kapaciteti i tij i përgjithshëm në aspektin e burimeve dhe pavarësisë;
- rregulloret dhe praktikat e brendshme drejtuese, duke u përqendruar në atë nëse institucioni është transparent dhe llogari-dhënës dhe vepron me integritet;
- shkalla në të cilën institucioni përmbush rolin që i është caktuar në kuadrin e sistemit të anti-korrupsionit, siç është sigurimi i mbikëqyrjes efektive të qeverisë (për gjyqësorin) apo parandalimi dhe hetimi i korrupsionit (për agjencitë kundër korrupsionit).

Gjatë vlerësimit të Sistemit të Integritetit Kombëtar shqyrtohen si kuadri ligjor ashtu edhe praktika reale e institucioneve, duke vënë në pah kështu mospërputhjet midis dispozitave formale dhe realitetit në terren. Vlerësimi është kryesisht cilësor (kualitativ) dhe në të janë kombinuar të dhënat parësore dhe dytësore, duke përfshirë legjislacionin kombëtar, raporte dhe hulumtime dytësore, teste në terren dhe intervista me ekspertë kyç.

Vlerësimet e Sistemit të Integritetit Kombëtar janë kryer në mbi 100 vende deri më sot, gjë që iu ka ofruar degëve të Transparency International dëshmi të fuqishme për nxitje kah reformave aq të nevojshme për të forcuar sistemet e anti-korrupsionit në vendet e tyre. Meqenëse vlerësimi kërkon të përfshijë në procesin e tij një komunitet më të gjerë të anti-korrupsionit, përgjegjësia e fuqishme vendore, konsultimet e gjera dhe marrëveshjet me aktorët kyç të anti-korrupsionit ndihmojnë që rekomandimet e nxjerra të integrohen në mënyrë efektive në kuadrin e avokimit dhe nismave për reformimin e politikave.

Vështrim i Përgjithshëm dhe Konteksti

Që prej fillimit të viteve '90, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë nisur të ecin ngadalë, por pa u ndalur, drejt demokratizimit. Duke e pasur integrimin në Bashkimin Evropian pikësynim të tyre, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, si dhe Turqia, kanë nënshkruar dhe ratifikuar Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit dhe kanë ndërmarrë hapa për të zhvilluar dhe fuqizuar sistemet e veta të anti-korrupsionit. Megjithatë, përparimi është i ngadaltë dhe zbatimi i ligjeve dhe politikave mbetet shumë prapa asaj që parashikohet në letër.

Është me rëndësi të shënojnë se dallimet historike midis vendeve të ish-Jugosllavisë dhe Turqisë (dhe në një farë mase edhe të Shqipërisë) kanë rezultuar në aranzhime shumë të ndryshme ligjore dhe institucionale. Po ashtu, ia vlen të theksohet se ky hulumtim është kryer në një kohë kur në Turqi ka pasur zhvillime të brendshme të konsiderueshme, të cilat kanë zhbërë me shpejtësi dekada të tëra reformash. Pavarësisht këtyre dallimeve, ekziston një numër tendencash që mund të gjenden në të gjithë rajonin.

Një përcaktues kryesor i faktit nëse një grup i caktuar i institucioneve dhe ligjeve të anti-korrupsionit ka të ngjarë të dëshmojë se është efektiv, është themeli social dhe politik mbi të cilin ngrihen këto institucione dhe ligje.

4 Shihni www.transparency.org/whatwedo/nis për informata të mëtejshme lidhur me metodologjinë e vlerësimit të Sistemit të Integritetit Kombëtar.

5 Të gjitha gjetjet në këtë raport janë nxjerrë nga shtatë raportet e SIK-ut, përveç nëse thuhet ndryshme: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Turqia

6 Shihni http://www.transparency.org/whatwedo/activity/turkey_and_western_balkans_national_integrity_systems

Në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në Turqi, këto themele janë të brishta, ku fragmentarizimi social dhe ndasitë etnike dhe fetare krijojnë një kontekst në të cilin favoritizmi dhe zbatimi i pabarabartë i ligjit përbëjnë normën dhe jo përjashtimin.

Në B&H, një sfidë kyçe ndaj përpjekjeve kundër korrupsionit është struktura e ndërlikuar kushtetuese dhe aparati shtetëror i stërmadh dhe etnikisht i ndarë. Përdorimi i retorikës përçarëse nga disa politikanë ka pasur një ndikim negativ në bashkëpunimin midis subjekteve që e përbëjnë vendin. Në mungesë të një narrative unifikuese, lulëzojnë nacionalizmi dhe përçarjet etnike dhe këto shpeshherë përdoren si vegël politike nga politikanë të cilët ndjekin interesat e veta. Për pasojë, integrimi shoqëror nuk ka marrë shumë përkrahje popullore, ndërkohë që qytetarët votojnë pothuaj ekskluzivisht sipas linjave etnike. Kjo krijon kushtet ideale për shfaqjen dhe ngulltjen e rrjetëve të patronazhit, gjë që përbën një pengesë serioze ndaj trajtimit të korrupsionit në vend.

Edhe tensionet ndër-etnike janë tipar i shoqërisë kosovare dhe maqedonase. Në Kosovë, këto tensione janë të dukshme sidomos në katër komunat veriore, ku popullsia serbe dominuese kërkon të ruajë praninë e institucioneve të Serbisë, ndërkohë që qeveria e Kosovës kërkon të vendosë plotësisht kontrollin e saj. Dialogu politik me Serbinë për normalizimin e marrëdhënieve nuk ka përparuar me seriozitet, pavarësisht përkrahjes aktive dhe investimeve të konsiderueshme nga ana e Bashkimit Evropian. Në Maqedoni, ndasitë janë më të rrepta midis qytetarëve maqedonas dhe atyre shqiptarë. Edhe pse Marrëveshja Kuadër e Ohrit, e nënshkruar në vitin 2001 midis partive politike që përfaqësonin maqedonasit etnikë dhe shqiptarët etnikë, ofron bazën për marrëdhënie ndër-komunitare, nuk ka burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore dhe bashkëpunim të përshtatshëm midis autoriteteve përkatëse për zbatimin me efektivitet të kësaj marrëveshjeje. Për pasojë, aktorët kryesorë politikë vazhdojnë të jenë të ndarë midis bllokut të maqedonasve etnikë dhe atij të shqiptarëve etnikë.

Në të njëjtën mënyrë, në Mal të Zi, ekziston një formë dualiteti në shumë fusha. Për shembull, ka dy kisha ortodokse, të cilat nuk e njohin njëra-tjetrën dhe herë pas here kanë konflikte verbale. Për më tepër, qytetarët e besimit islam ndahen në ata që e konsiderojnë veten myslimanë dhe ata që e konsiderojnë veten boshnjakë. Kur është fjala për minoritetin shqiptar, edhe këtu ka dy grupe: shqiptarët katolikë dhe shqiptarët myslimanë. Përçarjet midis qytetarëve bëhen veçanërisht të dukshme atëherë kur iu shkojnë për shtat interesave të strukturave në pushtet, zakonisht përpara zgjedhjeve.

Mungesa e kohezionit social është tipar edhe i shoqërisë serbe, ndonëse për shkaqe të ndryshme. Nxitësit kryesorë janë pabarazitë socio-ekonomike midis rajoneve dhe varfëria e vazhdueshme, të përkeqësuar

nga masat e shtrënguese të vendosura që prej vitit 2011. Minoritetet etnike kanë qasje në media në gjuhën e tyre dhe partitë e tyre politike dhe lloje të tjera të shoqatave. Liderhipi politik ka kërkuar të integrojë minoritetet kombëtare, mirëpo herë pas here ndeshet me probleme, në veçanti me komunat me shumicë shqiptarësh etnikë në jug të Serbisë dhe me rajonin e dominuar nga myslimanët/boshnjakët në jug-perëndim.

Marrëdhëniet e fuqishme midis patronit dhe klientit kanë ekzistuar që prej periudhës së Perandorisë Osmane. Në Turqinë moderne, këto marrëdhënie duken sidomos në zgjedhjet lokale, ku elita politike ofron burime dhe favore në këmbim të përkrahjes politike. Kësisoj, lidhet dhe përkatësia politike janë përcaktues të rëndësishëm të qasjes ndaj burimeve. Përjashtimi shoqëror dhe marginalizimi vihen re në shumë nivele: nga përkatësia etnike deri te gjinia dhe nga përkatësia fetare deri te seksualiteti. Numri zyrtar i minoriteteve në Turqi është i panjohur sepse etnia dhe feja nuk përfshihen në regjistrimin e popullsisë. As kushtetuta nuk i përmend të drejtat e minoriteteve. Krahas kësaj, është shumë e vështirë që minoriteteve t'i u dëgjohet zëri, sepse këto grupe mbeten të papërfaqësuar në politikat kryesore, ngaqë në zgjedhjet e përgjithshme për të zënë një vend në parlament duhen 10% të votave. Popullsia kurde në veçanti ka qenë e përfshirë në një konflikt të gjatë me shtetin, konflikt i cili ka çuar në vdekjen e mbi 30,000 njerëzve nga të dyja palët dhe në zhvendosjen brenda vendit të një pjese të konsiderueshme të popullsisë.

Shqipëria del disi ndryshe nga shumica e fqinjëve të saj. Bashkëjetesa fetare në Shqipëri është bërë marka e vendit në botën e jashtme. Këshilli Ndërfetar në Shqipëri shpeshherë ka mbledhur drejtuesit e komuniteteve të ndryshme fetare për të adresuar çështje që kanë qenë shqetësim i përbashkët. Për më tepër, drejtuesit fetarë shpeshherë marrin pjesë në festimet e grupeve të tjera fetare si shenjë respekti. Gjithashtu, Shqipëria është një vend disi më homogjen nga pikëpamja etnike, ku ekziston një klimë e përgjithshme e tolerancës dhe marrëdhënieve të mira ndër-etnike. Megjithatë, pavarësisht kësaj klime përgjithësisht pozitive, dhe sikurse ndodh në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, komunitetet rome dhe egjiptiane vazhdojnë të mbeten të marginalizuara dhe kanë më pak qasje në arsim, kujdes shëndetësor, shërbime sociale dhe në tregun e punës.

Rajoni i Ballkanit Perëndimor, i marrë në tërësi, karakterizohet edhe nga një ndasi e mprehtë midis zonave urbane dhe atyre rurale, përmes së cilës burime të mëdha janë centralizuar në kryeqytetet e vendeve, ndërkohë që banorët e zonave rurale migrojnë në zonat urbane ose jashtë shtetit. Kjo situatë nuk është përmirësuar për shkak të mungesës së strategjive për zhvillimin rural dhe rajonal, sidomos qasja në arsim dhe vende pune – një problem i qëndrueshmërisë afatgjatë ky, i cili është duke zbratur zona të mëdha fshatrash dhe duke i lënë me perspektiva të kufizuara për të ardhmen.

TIPARET KYÇE TË SISTEMEVE TË INTEGRITETIT KOMBËTAR NË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR DHE NË TURQI

Në përgjithësi, Sistemet e Integritetit Kombëtar të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë karakterizohen nga agjenci mbikëqyrëse relativisht të fuqishme e të pavarura (institucionet e auditimit të lartë, avokati i popullit dhe agjencitë kundër korrupsionit), ndërkohë që aktorët jo-shtetërorë dhe organet e zbatimit të ligjit/prokuroriale bëjnë pjesë të institucionet më të dobëta. Në mes, ndodhen tri degët e pushtetit shtetëror (legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori).

Një tipar konsistent në të gjitha vendet është dominimi i partive politike mbi pushtetin ekzekutiv dhe mbi të gjitha institucionet e tjera, si dhe mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit midis aktorëve shtetërorë. Të dy këta faktorë e minojnë aftësinë e agjencive të pavarura mbikëqyrëse për të ofruar mbikëqyrje kuptimplotë të veprimtarive dhe vendimeve qeveritare. Kështu, ndonëse disi më i fuqishëm sesa ndikimi i institucioneve të tjera në aspektin e kapacitetit për të funksionuar, ndikimi i agjencive të pavarura mbikëqyrëse rrezikohet seriozisht nga mos-veprimi i vazhdueshëm i qeverive dhe parlamenteve sipas rekomandimeve të tyre.

As aktorët jo-shtetërorë, sidomos media dhe shoqëria civile, nuk janë të pajisur me kapacitete të mjaftueshme dhe pavarësi të mjaftueshme për ta bërë qeverinë përgjegjëse në mënyrë efektive dhe të vazhdueshme. Kjo situatë përkeqësohet nga ndërhyrjet e përhapura politike në punën e organeve të zbatimit të ligjit dhe të atyre të drejtësisë, të cilat supozohen se janë të pavarura. Këto mosbaraspesha kanë pasoja serioze për funksionimin e Sistemeve të Integritetit Kombëtar të vendeve përkatëse. Rezultati përfundimtar është një situatë ku ligjet dhe politikat kundër korrupsionit, ndonëse të mira në letër, zbatohen në mënyrë selektive, ndërkohë që korrupsioni në zyrat publike kryesisht mbetet pa u ndëshkuar.

Si qëndrojnë në raport me njeri-tjetrin institucionet e Sistemeve të Integritetit Kombëtar në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në Turqi⁷?

Shtjellimi ynë, mbështetur në vlerësimet e Sistemeve të Integritetit Kombëtar, të realizuara nga Transparency International⁸.

7 Institucionet, të renditura sipas nivelit të fuqisë, mbështetur në informatat sasiore të paraqitura në vlerësimet e Sistemeve të Integritetit Kombëtar të shtatë vendeve. Pikët e përgjithshme për secilin institucion janë llogaritur duke mesatarizuar pikët e secilit vend për atë institucion.

8 Metodologjia e Sistemit të Integritetit Kombëtar pranon shprehimisht që dobësitë në çdo institucion të dhënë shpeshherë mund t'i vishen veprimeve të një institucioni tjetër apo të institucioneve të tjera. Për këtë arsye, për shembull, sektori i biznesit lidhet në mënyrë qenësore me ndikimin/përgjegjësinë e partive politike dhe interesat e tjera të fuqishme në rajon dhe nuk pasqyron komunitetin tregtar dhe sipërmarrës të shtypur, por tradicionalisht të gjallë, të bizneseve familjare dhe të vogla në vendet e Ballkanit Perëndimor.





DREJTËSI DHE ZBATIM I LIGJIT

1.

DREJTËSI DHE ZBATIM I DOBËT I LIGJIT

Në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC) rekomandohet që shtetet të krijojnë, krahas agjencive të zbatimit të ligjit, gjyqësorit dhe prokurorive, edhe një organ (ose disa organe) për të luftuar korrupsionin. Sipas Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), në modelet ekzistuese për organe të tilla të specializuara bëjnë pjesë: (a) agjencitë me shumë qëllime, me kompetenca përmbarimore dhe funksione parandaluese; (b) institucione të llojit përmbarimor; dhe (c) institucione për parandalim, hartim politikash dhe koordinim.⁹

Në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në Turqi, pjesa dërrmuese e organeve ekzistuese të anti-korrupsionit bëjnë pjesë në kategorinë e fundit. Kjo do të thotë se në pjesën më të madhe të rasteve, përgjegjësia për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit mbetet tjetërkund, ose shpërndahet nëpër shumë organe. Fragmentimi i funksioneve ndëshkuese ndërmjet institucioneve nuk është problematik në vetvete, për sa kohë këto institucione mund të operojnë pa u ndikuar nga ndërhyrje politike të panevojshme dhe janë në gjendje të bashkëpunojnë dhe të koordinojnë veprimtaritë me efikasitet. Për fat të keq, rajoni ka një historik shumë të dobët të ndjekjes penale të rasteve të korrupsionit, sidomos në radhët e zyrtarëve publikë të nivelit të lartë.

FIGURA 2 FUNKSIONET E ORGANEVE PARËSORE TË ANTI-KORRUPSIONIT NË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR DHE NË TURQI

Shtjellimi ynë, mbështetur në vlerësimet e Sistemeve të Integritetit Kombëtar, të realizuara nga Transparency International

Titulli i Tabelës	Koordinimi I Politikave	Parandalimi	Arsimi	Mbikëqyrja e Financave Politike	Hetimi	Ndjekja Penale
Shqipëria: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI)	Jo	Po	Pjesërisht	Jo	Jo	Jo
B&H: Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit dhe Koordinimin e Luftës kundër Korrupsionit	Po	Po	Po	Jo	Jo	Jo
Kosovë: Agjencia Kosovare kundër Korrupsionit	Po	Po	Po	Jo	Pjesërisht	Jo
Maqedonia: Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit (KSHPK)	Po	Po	Po	Jo	Pjesërisht	Jo
Mali i Zi: Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit	Po	Po	Po	Po	Jo	Jo
Serbia: Agjencia Kundër Korrupsionit	Po	Po	Po	Po	Pjesërisht	Jo
Turqia: Bordet Inspektuese	Po	Po	Pjesërisht	Jo	Pjesërisht	Jo

9 OECD, 2013, 'Specialised Anti-Corruption Institutions: Review of Models' [Institucionet e specializuara kundër korrupsionit: Rishikimi i modeleve] <https://www.oecd.org/corruption/acn/specialisedanti-corruptioninstitutions-reviewofmodels.htm>

Fragmentimi dhe lufta e brendshme institucionale

Pavarësisht ekzistencës së aranzhimeve ligjore dhe institucionale, organet kundër korrupsionit, ato gjyqësore dhe të zbatimit të ligjit duhet të punojnë ngushtë së bashku për të qenë efektive. Mosbashkëpunimi mund të çojë në izolim politik, gjë që i bën këto organe më të prekshme nga manipulimi dhe më pak të afta për të kryer funksionet e tyre. Për fat të keq, mungesa e bashkëpunimit institucional është një tipar i përbashkët i shumicës së vendeve në rajon, ndonëse për arsye të ndryshme.

Në Kosovë, problemi buron pjesërisht nga mbivendosja institucionale në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit, gjë që shkakton huti te qytetarët. Aktualisht, ekzistojnë shumë institucione që luajnë rol në adresimin e korrupsionit, duke përfshirë Këshillin e Presidentit Kundër Korrupsionit, Agjencinë Kosovare Kundër Korrupsionit (AKK), Task Forcën Kundër Korrupsionit në Zyrën e Prokurorisë Speciale, rrjetet e prokurorëve që koordinojnë rastet e korrupsionit në gjashtë prokurori themelore dhe në Prokurorinë e Prishtinës, si dhe Misionin e BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX). Ky fragmentim përkeqësohet nga fakti se Prokurorisë së Shtetit i mungojnë iniciativa, integriteti dhe burimet dhe për këtë arsye, në masë të madhe, nuk është efikase në luftën kundër korrupsionit.

Bashkëpunimi i kufizuar midis prokurorisë dhe policisë në kryerjen e hetimeve përbën një problem edhe në **Mal të Zi**. Shumica dërmuese e kallëzimeve penale që parashtrihen në Prokurorinë e Shtetit vijnë nga publiku (organizatat jo-qeveritare dhe firmat private). Kallëzimet penale rrallëherë parashtrihen nga policia, ndërkohë që ato që parashtrihen nga organet mbikëqyrëse apo agjencitë audituese janë jashtëzakonisht të rralla.

Pozita e Agjencisë **Serbe** Kundër Korrupsionit është dobësuar për shkak të ndarjes së paqartë të kompetencave për monitorimin e zbatimit të strategjisë kombëtare kundër korrupsionit midis Këshillit Qeveritar Kundër Korrupsionit, Ministrisë së Drejtësisë dhe organit të koordinimit qeveritar, i cili drejtohet nga kryeministri. Forcimi i rolit të agjencisë në të gjitha fushat e anti-korrupsionit parashkohet nga Strategjia Kundër Korrupsionit 2013-2018, edhe pse përparimi ka qenë i ngadaltë për shkak të mungesës së përkrahjen nga qeveria dhe parlamenti. Për më tepër, prokuroria publike as nuk përdor mjaftueshëm gjetjet e Agjencisë Kundër Korrupsionit apo ato të Këshillimit Kundër Korrupsionit për hetimet penale dhe as nuk bashkëpunon mjaftueshëm me policinë. Pak a shumë e njëjta gjë mund të thuhet edhe për Turqinë, ku bordet inspektuese vuajnë nga mungesa e qartësisë midis objektivave të tyre, roleve dhe përgjegjësisë në raport me njësitë e auditimit të brendshëm.

Edhe sistemi i drejtësisë në **Shqipëri** karakterizohet nga konflikte të ndryshme institucionale. Parlamenti ka hedhur poshtë 14 emërime presidenciale për në Gjykatën e Lartë që prej vitit 2008. Roli i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD), ndërkohë, është minuar si pasojë e një konflikti midis presidentit dhe parlamentit lidhur me shkarkimin, nga ana e këtij të fundit, në vitin 2014, të dy anëtarëve të KLD-së, të cilët ishin emëruar nga legjislatura e mëparshme¹⁰.

Në **B&H**, konflikti institucional merr formën e akuzave të shpeshta, të ashpra dhe publike midis prokurorive, gjykatave dhe agjencive të zbatimit të ligjit. Në shumë raste, këto akuzë reciproke kanë rezultuar në ngritjen e akuzave penale kundër zyrtarëve të lartë në prokurori dhe agjenci të zbatimit të ligjit. Këto praktika krijojnë një atmosferë mosbesimi në radhët e aktorëve kyç të cilët do të duhej të siguronin zbatim të ligjit në mënyrë të paanshme. Si për t'i përkeqësuar gjërat, fakti që B&H ka katër sisteme ligjore pothuaj tërësisht autonome (shteti, dy entitetet – njësi prej të cilëve ka dhjetë kantone – dhe Rrethi i Br ko-s), e bën bashkëpunimin ndër-institucional edhe më sfidues. Këto sisteme janë teorikisht të ndara nga njëra-tjetra. Veprimtaria e ligjvënësit, e cila rregullon punën e gjyqësorit dhe agjencive të zbatimit të ligjit, realizohet brenda këtyre juridiksioneve, pa harmonizim të mjaftueshëm. Ky aranzhim ka ndikime negative edhe për burimet për gjyqësorin, meqenëse fondet vijnë nga 14 buxhete të ndryshme lokale, gjë që e minon qëndrueshmërinë dhe parashikueshmërinë dhe e bën gjyqësorin të cenueshëm nga ndërhyrjet politike në proceset e buxhetimit. Të gjithë këta faktorë krijojnë hapësirë për praktika të pabarabarta gjyqësore, zbatim jo të njëtrajshëm të ligjeve dhe trajtim të pabarabartë të të njëjtave gjendjeve faktike dhe juridike, ndërkohë që kriminelët vazhdojnë të veprojnë të papenguar përtej këtyre kufijve administrativë.

Në **Maqedoni**, bashkëpunimi midis gjyqësorit, Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Prokurorisë për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin raportohet se është vazhdimisht i dobët ose jo-ekzistent¹¹. Në përpjekje për të adresuar këtë fragmentim dhe duke marrë parasysh krizën politike që shpërtheu pas publikimit të një serie përgjimesh telefonike në fundin e vitit 2015 (shihni më poshtë), qeveria krijoi Prokurorinë Speciale Publike si organ të posatshëm për të adresuar çështjet e korrupsionit në radhët e zyrtarëve të niveleve të larta në vend. Shkalla në të cilën ky organ i ri do të dëshmojë se është efektiv mbetet për t'u parë.

10 Shihni vlerësimin e SIK-ut për Shqipërinë

11 Shih vlerësimin e SIK-ut për Maqedoninë

Ndërhyrjet politike

Emërimet, shkarkimet dhe ngritjet në detyrë

Praktikat më të mira sugjerojnë se zyrtarët e lartë të organeve të anti-korrupsionit, gjyqësorit dhe të zbatimit të ligjit duhet të emërohen përmes një procesi që siguron pavarësinë, paanësinë, neutralitetin, integritetin, qëndrimin apolitik dhe kompetencën e tyre. Është me rëndësi thelbësore që udhëheqësit e organeve të anti-korrupsionit të kenë sigurinë e qëndrimit në detyrë, dhe procedurat e shkarkimit do të duhet të përfshijnë parlamentet, ku të votohet me dy të tretat e votave.¹² Në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në Turqi, këto parime nuk aplikohen kurrsesi në mënyrë universale.

Në **Serbi**, përfaqësuesit e pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ marrin pjesë në organet që emërojnë gjyqtarë dhe prokurorë. Edhe pse në këto organe profesionistët nga fusha e gjyqësorit përbëjnë shumicën, emërimet e prokurorëve dhe kryetarëve të gjykatave duke u mbështetur në lidhje politike kanë qenë të qarta në shumë raste të njohura.

Në **B&H**, edhe ndërhyrja politike në përzgjedhjen dhe emërimin e personelit të menaxhmentit besohet se është diçka e zakonshme. Zgjedhja e Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial (KLGJP) në vitin 2014 është një shembull i tillë. Më përpara, media kishte raportuar shumë për lidhjet që ai kishte me krimin e organizuar, ndërkohë që mbante pozitën e Kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Banja Luka¹³. Pavarësisht këtyre paralajmërimeve, në vend që të hapeshin procedura disiplinore apo procedura të hetimeve paraprake, ai u ngrit në detyrë, në një prej zyrave më të larta gjyqësore në vend. Që prej asaj kohe, KLGJP i është rikthyer operimit nën ndikimin e fuqishëm të elitave politike dhe ka zhbërë një dekadë me reforma të vështira lidhur me integritetin dhe profesionalizmin¹⁴.

Edhe në **Maqedoni**, emërimi i anëtarëve të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe përzgjedhja dhe ngritja në detyrë e gjyqtarëve janë të politizuara. Një seri përgjimesh që doli në fund të vitit 2015 vuri në pah, ndër të tjerash, se drejtori i shërbimit të sigurisë dhe kushëri i parë i kryeministrit mbanin një listë të kandidatëve të kualifikuar për gjyqtarë dhe jepnin urdhra lidhur me atë se cili do të ngruhej në detyrë dhe cili do t'i ndalohej të emërohej në pozitë të larta¹⁵.

Në **Shqipëri**, shqetësim të veçantë paraqet pozicioni i Prokurorit të Përgjithshëm. Ai/ajo emërohet me propozimin e presidentit dhe miratimin e shumicës së thjeshtë në kuvend. Këshilli Prokurorial, i cili mbikëqyr punën e prokurorëve, është një strukturë shumë formale dhe e dobët, e cila nuk është në gjendje të kontrollojë pushtetin që ka Prokurori i Përgjithshëm mbi karrierën dhe disiplinimin e prokurorëve. Për rrjedhojë, pothuaj

FORCIMI I PAVARËSISË SË GJYQËSORIT NË MAL TË ZI DHE NË KOSOVË

Mali i Zi ka kryer disa reforma të rëndësishme gjyqësore gjatë viteve të fundit. Amendamentet më të fundit në kushtetutë, të miratuara në vitin 2013, të pasuara nga miratimi i një kornize të re ligjore në vitin 2015, e kanë fuqizuar pavarësinë e gjyqësorit. Në reforma bën pjesë integrimi i parimit të palëvizshmërisë së gjyqtarëve dhe limitet për ndikimin politik në procesin e emërimit të gjyqtarëve. Ligji i ri ka hedhur edhe bazat për përmirësimin e bashkëpunimit midis prokurorisë dhe policisë përmes krijimit të një ekipe special hetimor, i cili, në rast nevojë, mund të formohet nga kryeprokurori special. Krahas kryeprokurorit special, ekipe mund të përbëhet nga zyrtarë policorë nga Departamenti i Policisë, hetues dhe nëpunës civilë nga organe të tjera kompetente. Ndonëse këto zhvillime janë premtuese, është shumë herët për të gjykuar se në çfarë shkalle do të ndikojnë këto në praktikë.

Edhe Kosova ka kryer disa reforma të rëndësishme gjyqësore. Ligjet për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) u ndryshuan në qershor të vitit 2015, duke iu dhënë të dyja institucioneve më shumë diskrecion në hartimin dhe propozimin e buxheteve të tyre në Kuvendin e Kosovës. Krahas kësaj, ndryshimet ligjore të bëra në mars të vitit 2016 në harmoni me rekomandimet e Komisionit të Venecias tashmë kërkojnë që shtatë anëtarë të KGJK-së të emërohen nga gjyqësori dhe vetëm dy nga Kuvendi i Kosovës. Më parë, KGJK-ja përbëhej nga 13 anëtarë, nëntë prej të cilëve emëroheshin nga kuvendi.

80% e prokurorëve besojnë se formula aktuale e emërimit të Prokurorit të Përgjithshëm nuk ofron garanci për pavarësi dhe do të duhet të ndryshohet. Nga katër prokurorë të përgjithshëm që kanë qenë në detyrë që prej hyrjes në fuqi të kushtetutës së vitit 1998, dy janë shkarkuar nga zyra përmes komisioneve hetimore parlamentare. Të dyja rastet u referuan në Gjykatën Kushtetuese, e cila mori vendim në favor të prokurorëve të përgjithshëm, edhe pse këto vendime nuk u zbatuan kurrë. Ndërhyrjet politike në Shqipëri janë të dukshme edhe në radhët e forcave të policisë, e cila pëson lëvizje masive pas ndryshimeve në qeveri dhe, në një shkallë më të ulët, gjatë së njëjtën administratë. Në këtë mënyrë, për shembull, gjatë vitit të parë të qeverisë së majtë të re (shtator 2013 – shtator 2014), më shumë sesa 60 për qind e forcave të policisë u pushuan nga puna, u ulën në detyrë, u transferuan, u pranuan ose u ri-pranuan.

12 Transparency International, 2013, 'Best Practices for Anti-Corruption Commissions' [Praktikat më të mira për Komisionet Kundër Korrupsionit], 21 mars http://www.transparency.org/whatwedo/answer/best_practices_for_anti_corruption_commissions

13 Shih vlerësimin e SIK-ut për B&H

14 Bertelsmann Stiftung, 2016, 'BTI 2016: Bosnia and Herzegovina Country Report' [Raporti për Bosnjën dhe Hercegovinën] https://www.bti-project.org/fileadmin/files/BTI/Downloads/Reports/2016/pdf/BTI_2016_Bosnia_and_Herzegovina.pdf

15 Shih vlerësimin e SIK-ut për Maqedoninë

Situata në **Turqi** është veçanërisht shqetësuese. Në vitin 2010, Turqia zbatoi një gamë ndryshimesh të konsiderueshme kushtetuese për administratën gjyqësore. Një rezultat i këtyre ndryshimeve ishte forcimi i pranisë së ministrit të drejtësisë dhe nënsekretarit në Këshillin e Lartë të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (HSYK), gjë që vuri në hije pavarësinë e gjyqësorit. Më pas pati shumë ri-emërime dhe shkarkime gjyqtarësh dhe prokurorësh, si dhe ri-emërime, shkarkime deri edhe arrestime të një numri të madh të zyrtarëve policorë. Më vonë, pas shpërthimit të një skandali korrupsioni me përmasa të gjera në dhjetor të vitit 2013, ku u arrestuan me akuzë për korrupsion më shumë sesa 50 individë të lidhur me partinë në pushtet – Partia për Drejtësi dhe Zhvillim (AKP) – dhe 784 gjyqtarë gjyqësore dhe 104 gjyqtarë administrativë dhe prokurorë të lidhur me hetimin, u riemëruan në pozita të tjera. Situata u përkeqësua edhe më shumë pas dështimit të grushtit të shtetit të korrikut të vitit 2016. Brenda pak ditësh, Këshilli i Lartë i Gjyqtarëve dhe Prokurorëve kishte nxjerrë një listë me 2,745 gjyqtarë dhe prokurorë që do të pezulloheshin për shkak të dyshimeve se ishin anëtarë të lëvizjes së Gylenit (shihni më poshtë). Krahas kësaj, do të hetoheshin edhe 48 anëtarë të Këshillit të Shtetit, dy anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, 140 anëtarë të Gjykatës së Kasacionit dhe katër anëtarë të HSYK-së. Më 27 korrik 2016, Ministri i Punëve të Brendshme shpalli se ishin burgosur 1,684 gjyqtarë dhe prokurorë¹⁶.

Operacionet dhe Vendimmarrja

Siç ka ndërhyrje në emërime, transferta dhe heqje nga puna, ka edhe raste të shumta të ndërhyrjeve të pajustificuara politike në operimin e përditshëm dhe proceset vendimmarrëse të organeve gjyqësore dhe të anti-korrupsionit.

Në **B&H**, ekzekutivi ushtron haptas presion mbi prokuroritë përmes nxjerrjes së kërkesave dhe kërcënimeve në publik. Në një rast të këtij lloj presioni, presidenti i Republika Srpska-s (RS: një prej dy entiteteve të B&H) kërcënoi se do të nxirrte jashtë ligjit një gjykatë lokale, pasi ajo kishte marrë vendim të ngrinte llogarinë bankare të një kompanie, e cila ishte vendosur nën kontrollin e qeverisë pas dështimit të privatizimit të saj. Në shembull tjetër ishte arrestimi i kryetarit të partisë së Bashkimit për një të Ardhme më të Mirë për B&H (SBB B&H) dhe i Ministrit të Sigurisë, Fahrudin Radon i . Bartësit e funksioneve më të larta shtetërore u përpoqën të ushtronin presion të drejtpërdrejt mbi gjykatat për të ndryshuar vendimet e tyre lidhur me arrestimin e Radon i -it. Veçanërisht shqetësuese ishin deklaratat e bëra nga anëtarët e Presidencës së B&H, të cilët iu kërkonin gjykatave të ndryshonin vendimet e tyre dhe i akuzonin ato për përpjekje për dëmtim të koalicionit udhëheqës¹⁷.

POLICIA E KOSOVËS: E PAVARUR DHE E BESUAR

Krahasuar me fqinjët e saj, në Kosovë pavarësia institucionale e policisë është relativisht e fuqishme. Kjo ndodh për shkak se kriteret për përzgjedhjen, emërimin dhe shkarkimin e zyrtarëve janë relativisht objektive dhe transparente. Për të siguruar zbatimin në praktikë të rregullave, ekziston një grup inspektoratesh që mbikëqyr aktivitetet e policisë. Për më tepër, Policia e Kosovës është bërë më transparente gjatë pesë viteve të fundit, duke përgatitur raporte ditore, të cilat mund të bëhen të qasshme përmes një kërkesë. Për rrjedhojë, policia është institucioni më i besuar i zbatimit të ligjit në Kosovë.

Një situatë e ngjashme ekziston në **Serbi**, ku ekzekutivi ka miratuar së fundmi praktikën e komentimit publik lidhur me proceset gjyqësore dhe shpalljes publike të arrestimeve dhe paraburgimeve në media përpara se gjykatat të nxjerrin vendimet. Kjo konsiderohet e dëmshme për pavarësinë e gjyqësorit dhe përkeqësohet edhe më shumë nga fakti se menjëherë kur bie interesi i medias, bie edhe përcjellja e këtyre rasteve. Pavarësia rrezikohet më tej nga politizimi i hetimeve dhe krijimi i ekipeve të posatshme për hetimin e rasteve që priorizohen nga politikanë.

Në **Turqi**, pavarësia operative e prokurorëve kompromentohet sepse kryeprokurori apo zëvendësit e tij mund t'ia transferojnë rastet e prokurorëve të tjerëve, pa dhënë arsyetimet e duhura. Për më tepër, zëvendës prokurorët duhet të miratojnë dosjet e plotësuara nga prokurorët publikë përpara se t'i përcillen gjykatës edhe pse një mekanizëm i tillë miratimi nuk ekziston në legjislacion.

Edhe në **Shqipëri dhe Maqedoni**, raportet e ndërhyrjeve politike në vendimet gjyqësore janë të zakonshme. Asnjë prej rasteve penale të hapura kundër zyrtarëve qeveritarë në detyrë në Shqipëri nuk ka përfunduar në dënim, ku Gjykata e Lartë dhe prokuroria fajësojnë njëra-tjetrën për dështimet. Të vetmit politikanë që janë shpallur fajtorë nga Gjykata e Lartë janë anëtarë të opozitës në parlament, të akuzuar për shpifje nga anëtarët e ekzekutivit apo bashkëpunëtorë të ngushtë. Në Maqedoni, ndërkohë, këto praktika ilustrohen me rastin e ndërhyrjes së pretenduar të Ministrit të Punëve të Brendshme për të kërkuar që prokurori publik ta rrëzonte akuzën kundër zëvendës krye ministrit, i cili ishte akuzuar për një krim që kishte të bënte me detyrat zyrtare¹⁸. Prokurori publik nuk e ndoqi penalisht rastin.

16 Human Rights Watch, 2016, 'Turkey: Judges, Prosecutors Unfairly Jailed', [Turqia: Burgosen pa të drejtë gjyqtarët dhe prokurorët], 5 gusht www.hrw.org/news/2016/08/05/turkey-judges-prosecutors-unfairly-jailed

17 <http://www.fokus.ba/vijesti/bih/bakir-izetbegovic-fahrudin-radoncic-zasluzuje-da-se-brani-sa-slobode-foto/205715/>

18 Shih vlerësimin e SIK-ut për Maqedoninë

Drejtësi selektive

Rezultati përfundimtar i dobësive të identifikuara më sipër është historiku vazhdimisht i dobët në aspektin e ndëshkimit të rasteve të korrupsionit, sidomos në radhët e zyrtarëve të nivelit të lartë. Kjo është arsyeja kyçe për të cilën publiku nuk ka besim në institucione, integritetin e tyre dhe në çdo zotim për luftimin e korrupsionit.

Në **B&H**, politikat penale për aktet e korrupsionit janë të dobëta. Ekziston një prirje e dukshme në radhët e institucioneve gjyqësore të niveleve më të larta për të injoruar të gjitha rastet e korrupsionit. Edhe atëherë kur nisen hetime kundër zyrtarëve të nivelit të mesëm apo të lartë, ato zakonisht zvarriten për vite të tëra dhe përfundojnë me lirime nga akuzat. Për rrjedhojë, gjatë periudhës 2009-2014, vetëm 19 për qind e të gjitha këtyre rasteve kanë përfunduar në ndjekje penale¹⁹. Ndërkohë, dënimet zakonisht janë pranë minimumit ligjor të parashikuar nga ligji, dhe në disa raste edhe më të ulëta, ku vetëm 20 për qind e personave të shpallur fajtorë dënohen me burg, dhe pjesa tjetër merr vetëm dënime me lirim me kusht.


Në **Kosovë**, numri i rasteve që kanë të bëjnë me korrupsionin dhe që janë sjellë para drejtësisë është i vogël dhe në rënie, ku dënimet për korrupsion pothuaj përgjysmohen në periudhën midis vitit 2009 dhe 2012, periudhë që përkon me tërheqjen e komunitetit ndërkombëtar dhe me marrjen e kontrollit nga ana e autoriteteve kombëtare. Aktakuzat shkruhen keq dhe nuk hetohen si duhet, ndërkohë që shumë prej ndërlikimeve të rasteve të korrupsionit shkojnë përtej asaj që kupton prokurori i shtetit, gjë që ua bën gjyqtarëve të vështirë të marrin vendime të mirë-informuara dhe të mirë-arsyetuara.

Edhe në **Mal të Zi**, procedurat për rastet e korrupsionit janë shumë të gjata, ndërsa politikat penale mbeten të pabarabarta. Pothuaj çdo procedurë e nisur para gjykatave ka të bëjë me raste të korrupsionit të vogël. Ka pasur vetëm pak procedura kundër zyrtarëve shtetërorë të nivelit të mesëm për vepra më të mëdha të korrupsionit, ndërkohë që dënimet kanë qenë edhe më të pakta. Edhe kur shpallen këto dënime, ndëshkimet janë të buta, të pabarabarta dhe jo konsistente. Nga ana tjetër, zyrtarët e niveleve më të ulëta të akuzuar për korrupsion me shuma të vogla dënohen me burg, gjë që rrit statistikisht zyrtarët të ndjekjes penale.

Në **Serbi**, numri i rasteve të korrupsionit, të raportuara dhe të ndjekura penalisht, rritet çdo vit, por dënimet në rastet e profileve të larta janë jashtëzakonisht të rralla dhe proceset gjyqësore zgjasin për një kohë shumë të gjatë. Në të njëjtën kohë, ka raporte të shumta mediatike lidhur me ndërhyrjet e panevojshme në punën e medias dhe institucioneve të pavarura, raporte këto të cilat nuk hetohen.

Bilanci i **Shqipërisë** në ndëshkimin e rasteve të korrupsionit është po aq i dobët. Ndëshkimet vjetore për veprat penale të korrupsionit kanë variuar nga dy deri në 24 gjatë periudhës 2009-2014, ku dominojnë kundërvajtësit e nivelit të mesëm dhe të ulët në sektorin publik. Ndëshkimet e zyrtarëve të nivelit të lartë janë jashtëzakonisht të rralla. Gjyqtarët aplikojnë ndëshkime të buta, duke përdorur dënimet me periudhë provuese dhe aktgjykime përmbledhëse, dhe nuk i arsyetojnë ato me kohë ose nuk i arsyetojnë fare. Për më tepër, gjyqtarët shfaqin nivele të ulëta të të kuptuarit të nocioneve kyçe në rastet e korrupsionit, nuk arrijnë të ushtrojnë të drejtën e tyre për të kërkuar më shumë prova dhe vendosin në mënyrë jokonsistente mbi çështje të tilla si pranueshmëria e provave. Në vitin 2013, prokuroria nuk raportoi asnjë rast të zyrtarëve të nivelit të lartë, gjyqtarëve, apo prokurorëve që ishte dërguar në gjykatë.

19 TI-BiH, 2015, 'Monitoring procesuiranja korupcije pred sudovim i tužilaštva u Bosni I Hercegovini' <https://ti-bih.org/wp-content/uploads/2015/12/Monitoring-procesuiranja-korupcije-16-12-2015.pdf>



SISTEME POLITIKE TË KAPURA

2.

SISTEME POLITIKE TË KAPURA

Dobësia në zbatimin e ligjit në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në Turqi mund t'i atribuohet në pjesën më të madhe sistemeve politike të kapura, të cilat janë zhvilluar që prej fillimit të viteve '90. Aktorët politikë kanë ndikim të madh pothuaj në të gjitha sferat e jetës publike dhe shpesh kanë lidhje të ngushta me biznesmenë të pasur privatë dhe rrjete të krimit të organizuar, gjë që minon shtetin e së drejtës. Kjo situatë përkeqësohet nga monitorimi i dobët i partive politike dhe i transparencës së kufizuar të tyre, gjë që do të thotë se shkeljet e rregulloreve të zgjedhjeve dhe fushatave nuk dënohen pothuaj asnjëherë. Për këto arsye, ndoshta mund të mos jetë e habitshme që partitë politike shihen nga qytetarët si disa prej institucioneve më të korrupsuara, ku pothuaj tre të katërtat e qytetarëve në rajon i konsiderojnë ato si të korrupsuara ose jashtëzakonisht të korrupsuara (shihni më poshtë).

Patronazhi politik dhe kërcënimi

Partitë politike në **B&H** janë pak më shumë sesa grupe interesi, të cilat përfaqësojnë më shumë interesat personale, financiare dhe politike të udhëheqësve të tyre sesa interesat e qytetarëve. Në praktikë, shpeshherë ka konflikt interesash brenda vetë partive, kryesisht lidhur me shpërndarjen e funksioneve apo fitimeve të nxjerra nga ndërmarrjet dhe institucionet publike. Për më tepër, rregulloret ekzistuese nuk i ndajnë funksionet partiake nga funksionet profesionale në ndërmarrjet dhe institucionet publike, dhe nuk ka kufizime për zyrtarët publikë të cilët e përdorin pozitën e tyre për të promovuar partinë e tyre politike apo veten si kandidatë. Manipulimi i sistemit politik nga ana e partive politike është ilustruar me një audio-inçizim të zbuluar të kandidatës së atëhershme për kryeministër të qeverisë së Republika Srpska-s, pas zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2014, në të cilën ajo thoshte se sugjeronte të bliheshin votat e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar të RS-së²¹. Ky rast demonstroi edhe shkallën në të cilën policia e RS-së është nën kontrollin e partisë në pushtet. Policia më pas bastisi ambientet e degës së medias që kishte publikuar incidencën dhe filloi një hetim lidhur me atë se cili kishte qenë përgjegjës për zbulimin e incidencës, por dështoi në kryerjen e hetimit të duhur të pretendimeve për blerje votash, pavarësisht faktit se anëtarët e kuvendit që përmendeshin në incidencë më vonë ndërruan krahët dhe shërbyen si instrument për të siguruar që partia në pushtet të ruante shumicën në kuvend.




FIGURE 3 PËRQINDJA E QYTETARËVE TË CILËT BESOJNË SE PARTITË POLITIKE JANË TË KORRUPTUARA/JASHTËZAKONISHT TË KORRUPTUARA*

Transparency International, 2013, 'Global Corruption Barometer' [Barometri Global i Korrupsionit]

*Mali i Zi nuk u mbulua nga ky anketim

Në **Maqedoni**, panorama politike dominohet nga koalicioni qeverisës i udhëhequr nga VMRO-DPMNE, i cili ushtron presion mbi anëtarët e partive më të vogla që t'i bashkohen koalicionit. Për rrjedhojë, disa politikanë nga partitë politike të vogla i janë bashkangjitur VMRO-DPMNE-së me qëllim që të rrisin mundësitë për fitore në zgjedhje. Një seri përgjimesh të zbuluara gjatë vitit 2015 vunë në pah shkallën e ngacmimit dhe sulmeve mbi kundërshtarët politikë²¹. Për shembull, midis incidencave kishte biseda midis anëtarëve kryesorë të qeverisë lidhur

20 Shih vlerësimin e SIK-ut për B&H

21 Shih vlerësimin e SIK-ut për Maqedoninë

me mbulimin mediatik të arrestimit të Ljube Boshkoski-t, udhëheqës i një partie opozitare, dhe pushimin nga puna të njerëzve të punësuar në institucione publike, të cilët nuk ishin anëtarë të VMRO-DPMNE-së.

Në **Turqi**, shpërbërja e partive politike është përdorur si mjet politik për të shuar disidencën. Veçanërisht dy raste e ilustron këtë prirje. Rasti i parë u hap kundër partinë në pushtet – Partia për Drejtësi dhe Zhvillim, për shkak të pretendimeve për veprime kundër establishmentit laik të shtetit në vitin 2008. AKP-ja shpëtoi për pak nga shpërbërja kur gjashtë nga 11 anëtarë të Gjykatës Kushtetuese votuan kundër kësaj lëvizjeje. Rasti i dytë ishte kundër Partisë pro-Kurde të Shoqërisë Demokratike (DTP) për shkak të pretendimeve për veprime kundër pandashmërisë së shtetit në vitin 2009. DTP-ja u shpërbë dhe të 37 anëtarëve të partisë, duke përfshirë dy anëtarë të parlamentit dhe katër kryetarë rajonalë, iu ndalua të merreshin me politikë për pesë vite.

Kontrolli politik në **Mal të Zi** mbahet në pjesën më të madhe përmes presionit mbi burimet financiare të partive më të vogla opozitare: kompanitë dhe individët kanë frikë të bëjnë donacione për partitë opozitare për shkak se i druhen hakmarrjes së autoriteteve. Në të njëjtën kohë, partia kryesore në pushtet ka krijuar të ardhura të konsiderueshme duke ia dhënë me qira ambientet e saj qeverisë gjatë fushatave zgjedhore, duke shpërdoruar vërtet fondet shtetërore për qëllime elektorale. Një seri bashkëbisedimesh të incizuara, të publikuara nga një prej të përditshmeve të Malit të Zi në fillim të vitit 2013, nxori në pah diskutimet midis zyrtarëve të lartë lidhur me strategjitë për blerjen e votave, duke përfshirë ofrimin e mundësive të punësimit për votuesit dhe ofrimin e përfitimeve sociale me një transaksion të vetëm, subvencione dhe përfitime të tjera në këmbim të votave. Bashkëbisedimet gjithashtu

nxorën në dritë përpjekjet për manipulimin e regjistrit elektorale, gjë që ngre shqetësime serioze lidhur me vlefshmërinë e rezultateve të zgjedhjeve.

Kontrolli politik në **Kosovë** ushtrohet në mënyrën më të hapur përmes ndërmarrjeve shtetërore, tipar ky që Kosova e ka të përbashkët me shumë prej fqinjëve të saj. NSH-të në Kosovë menaxhohen në të vërtetë nga partitë politike, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në aktivitetet e përditshme dhe vendimet strategjike të NSH-ve, punëdhënësit dhe nxitësit më të mëdhenj të ekonomisë. Për shembull, partitë politike thonë fjalën e fundit në emërimin, kontrollimin dhe shkarkimin e anëtarëve/drejtorëve të bordeve të NSH-ve. Gjithashtu, ato kanë diskrecion të caktojnë drejtorët ekzekutivë të NSH-ve, të cilët iu nënshtrohen presioneve për të nënshkruar kontrata, për të marrë vendime dhe për të zbatuar politikën e bordit në emër të kompanive apo grupeve të interesit të cilat mbështesin financiarisht partitë politike. Praktika të ngjashme të kontrollit të rrjedhës së tregtisë, subvencioneve dhe prokurimit dhe caktimit të individëve besnikë, duke përdorur NSH-të, ekzistojnë në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.

Mbikëqyrja e dobët e financave politike

Në kuadrin e ndërhyrjeve të përhapura në sistemin politik, është edhe më e rëndësishme që të sigurohet mbikëqyrja e fuqishme e partive politike dhe që burimet e fondeve politike të jenë transparente. Megjithatë, për shkaqe të ndryshme, kjo mbikëqyrje ose mungon në masë të madhe, ose është shumë e fragmentuar për të qenë efektive. Edhe atëherë kur vendosen ndëshkime, ato shpeshherë janë shumë të buta për t'i përmbajtur partitë politike nga shkelja e ligjit. Një lidhje e dobët e

FIGURA 4 INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR MBIKËQYRJEN E FINANCAVE POLITIKE

Shtjellimi ynë, mbështetur në vlerësimet e Sistemeve të Integritetit Kombëtar, të realizuara nga Transparency International

Lloji i Institucionit të Mbikëqyrjes	Organ për Administrimin e Zgjedhjeve	Agjenci Auditimit	Gjykatë	Agjenci Kundër Korrupsionit	Tjetër
Shqipëria	X				
B&H	X				
Kosova	X				
Maqedonia	X	X		X	X
Mali i Zi	X		X		
Serbia		X		X	
Turqia			X		X

përbashkët në të gjitha sistemet zgjedhore në rajon janë organet e administrimit të zgjedhjeve, të cilët operojnë në pesë nga shtatë vendet që mbulohen në këtë punim dhe që vazhdimisht vlerësoheshin se kishin performancë të dobët krahasuar me institucionet e tjera në Sistemet e Integritetit Kombëtar.

Në **B&H**, mbikëqyrja e partive politike pengohet nga pamjaftueshmëria e burimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), i cili mbikëqyr raportet financiare të partive politike. Për më tepër, meqenëse KQZ nuk ka kompetenca të kryejnë kontrole të detajuara të mënyrën se si shpenzohen burimet e partive, partitë politike janë të lira t'i shpenzojnë paratë e taksapaguesve ashtu si t'iu vijë për mbarë. Krahas kësaj, fakti që ligji nuk iu kërkon partive politike të përdorin një llogari të vetme bankare për të gjitha transfertat hyrëse dhe dalëse ka për pasojë përdorimin e parave të gatshme dhe pengon kontrollin financiar. Edhe pse janë bërë disa përpime në aspektin e eliminimit të pengesave ndaj publikimit të identitetit të donatorëve individualë të partive, ekzistojnë shumë aspekte të operacioneve të partive të cilat mbetet jashtëzakonisht të errëta. Mungesa e pasqyrave të hollësishme të auditimit të kostove të partive dhe disponueshmëria e kufizuar për publikun e shifrave të shpenzimeve të partive, për shkak të kompetencave të përcaktuara në mënyrë të pasaktë të KQZ-së, lënë hapësirë të bollshme për parregullsi.

Një panoramë e ngjashme shfaqet edhe në **Kosovë**. Ndonëse partive politike iu kërkohej t'ia paraqesin raporte financiare Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), në praktikë këto raporte janë të paplota dhe të pasakta, sidomos kur është fjala për zbulimin e burimeve të të ardhurave nga donatorët privatë. Ndërkohë, KQZ nuk ka kapacitet të mjaftueshme për t'i gjurmuar më nga afër fondet e partive politike. Të gjitha raportet financiare vjetore dhe deklarimet e fondeve të fushatave i nënshtrohen auditimit, por sipas ligjit të ri, KQZ nuk është më përgjegjëse për auditimin. Në vend të kësaj, të paktën dhjetë auditorë të licencuar zgjidhen nga Komiteti për Mbikëqyrjen e Financave Publike përmes një shpalljeje të hapur publike, gjë e cila pritet të ndodhë. Si pasojë e këtij hendeku, auditimi i raporteve financiare të partive për vitet 2013 dhe 2014 nuk është kryer.

Ushtrimi i kontrollit financiar mbi partitë politike në **Maqedoni** është i shpërndarë në institucione të ndryshme dhe është i minuar nga dobësia e mekanizmave të auditimit dhe verifikimit. Kësisoj, praktika e partive që shpenzojnë shumën që i tejkalojnë depozitat në llogaritë bankare të hapura enkas nuk është e pazakontë. Këto raste nuk janë audituar dhe verifikuar me efikasitet nga ana e organeve përgjegjëse. Megjithatë, bashkëpunimi midis institucionit të lartë të auditimit dhe organeve të tjera të përfshira në mbikëqyrjen e financimeve politike (Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit: KSHPK) është përmirësuar, dhe ka filluar të zhvillohet një historik ndëshkimesh.

NJË PANORAMË NË PËRMIRËSIM NË SERBI

Në Serbi, gjatë pesë viteve të fundit, ka pasur përmirësim të konsiderueshëm lidhur me transparencën e informatave financiare të partive politike. Përmirësimi vjen kryesisht si rezultat i pajtueshmërisë me dispozitat e reja ligjore, në fuqi që prej vitit 2012. Ka pasur edhe një përmirësim të dukshëm në mbikëqyrjen financiare të partive politike në praktikë. Të gjitha partitë kryesore ia dërgojnë raportet e tyre financiare vjetore, raportet për donacionet dhe raportet për kostot e fushatës elektorale Agjencisë Kundër Korrupsionit. Megjithatë, përmirësimet e konsiderueshme legjislative gjatë pesë viteve të fundit dhe rritja e transparencës dhe mbikëqyrjes nuk kanë çuar në rritje të besimit të publikut se raportet financiare janë gjithëpërfshirëse. Për më tepër, ndikimi i partive politike në sektorin publik ende konsiderohet si një nga shkaqet kryesore të korrupsionit.

Në **Shqipëri**, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është përgjegjës për mbikëqyrjen e fondeve publike dhe private të partive politike, ndërkohë që Kontrolli i Lartë i Shtetit mund të auditojë partitë politike për fonde të akokuara nga buxheti i shtetit. Pavarësia e pamjaftueshme e të dy organeve lë hapësirë për vendimmarrje të njëanshme dhe diskriminuese, ankesë kjo e përbashkët e partive më të vogla. KQZ, për shembull, ka vetëm dy anëtarë personeli për të menaxhuar procesin e mbikëqyrjes së financave të partive politike dhe mbështetet te ekspertët e jashtëm të certifikuar të kontabilitetit. Për më tepër, afatet për dorëzimin e raporteve financiare nuk janë fikse dhe nuk ekziston kurrfarë detyrimi për shpalljen e informatave financiare gjatë fushatave. Pragu i donacioneve mbi të cilin bëhet e detyrueshme shpallja e identitetit të donatorëve është i lartë dhe i formuluar në mënyrë të paqartë, duke lënë hapësirë për ndarje artificiale dhe më pas fshehje të fondeve, ndërkohë që pragu i shpenzimeve për fushatën është tepër i lartë për të pasur ndonjë peshë për këtë. Shumë të pakta janë partitë që dorëzojnë raportet e tyre financiare në kohë, ku vetëm dhjetë për qind e partive të regjistruara në gjykatë i kanë dorëzuar raportet e tyre në vitin 2014.

Ndryshe nga homologët e saj në Evropë, në **Turqi** nuk ka asnjë agjenci të pavarur me mandat për mbikëqyrjen e operacioneve dhe financave të partive politike në Turqi. Në vend të saj, është autorizuar Gjykata Kushtetuese për të bërë auditimin e llogarive financiare të partive politike dhe sqarimin e tyre.



MEDIA DHE SHOQËRIA CIVILE

3.

MEDIA DHE SHOQËRIA CIVILE NËN KËRCËNIME

Në mungesë të llogaridhënies së fuqishme horizontale dhe mekanizmave funksionalë të zbatimit të ligjit, është edhe më vendimtare që aktorët jo-shtetërorë të kenë si kapacitetin, ashtu edhe lirinë për t'iu kërkuar llogari aktorëve politikë. Kjo panoramë në këtë pikëpamje është disi e zymtë në të gjithë rajonin. Format e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të presionit si mbi median, ashtu edhe mbi OSHC-të përfshijnë sulmet fizike; fushatat njollosëse dhe padi për shpifje (sidomos kundër atyre që marrin financime nga jashtë vendit); përdorimin e reklamave qeveritare për të financuar mediat që janë pro qeverisë, nga njëra anë dhe, në anën tjetër, përdorimin e inspektimeve tatimore dhe zbatimit të pabarabartë të ligjit për të kërcënuar mediat që janë kritike ndaj qeverisë; përdorimin e legjislacionit kundër terrorizmit për të censuruar dhe ndjekur penalisht gazetarë dhe aktivistë; dhe kooptimin e OSHC-ve për të promovuar interesat e qeverisë.

Nuk është për t'u habitur pra, që, sipas rankimit të vitit 2016 të bërë nga Freedom House në raportin "Liria e Shtypit", vendet e mbuluara në këtë raport përbëjnë shtatë nga nëntë performuesit më të këqij për lirinë e shtypit në Evropë²². Turqia dhe Maqedonia dallohen për regjistrimin e rënieve më të mëdha në indeks. Në Turqi, kjo rënie i atribuohet burgosjes të gazetarëve mbi bazën e akuzave të rreme, kufizimeve të shërbimit të internetit, kufizimeve për gazetarët e huaj, dhunës ndaj personelit mediatik dhe në ambiente mediatike dhe ndryshimeve të menjëhershme të rregulloreve për mediat²³. Ndërkohë, Maqedonia është i vetmi vend në Evropën Jug-Lindore (me përjashtim të Turqisë) që ka një gazetar të burgosur. Gazetari në fjalë është dënuar me katër vite e gjysmë për shkak se pretendohet se kishte zbuluar identitetin e një dëshmitari të mbrojtur në një proces gjyqësor për vrasje. Ai njihen shumë për bllogun e tij me tema nga politika, i cili ishte kritik ndaj qeverisë²⁴.




FIGURA 5 LIRIA E SHTYPIT NË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR DHE NË TURQI

Freedom House, 'Freedom of the Press 2016' [Liria e Shtypit 2016]

Shënim: 0 nënkupton nivelin më të lartë të lirisë dhe 100 nënkupton atë më të ulët.

²² Freedom House, 2016, 'Freedom of the Press 2016 [Liria e Shtypit 2016]' <https://freedomhouse.org/report/freedom-press/freedom-press-2016>

²³ Ibid.

²⁴ Ibid.

Kontrolli i qeverisë dhe kërcënimi

Në **B&H**, pjesa më e madhe e medias varet dhe kontrollohet nga elita në pushtet dhe oligarkitë e fuqishme. Institucionet e qeverisë mbeten reklamuesit më të mëdhenj, gjë që ato e përdorin si mjet për të financuar media, politikat editoriale të cilave ua promovojnë interesat. Kjo shihet sidomos gjatë fushatave elektorale, atëherë kur vihen haptas në shërbim të partive në pushtet. Nga ana tjetër, mediat që janë kritike ndaj qeverisë shpeshherë përballen me presione dhe kërcënime, si dhe dhunë fizike nga politikanë apo grupe kriminale. Pak media që vërtetë praktikojnë gazetarinë investigative ekspozohen ndaj hetimeve spontane dhe kontrolleve fiskale dhe tatimore. Për më tepër, edhe atëherë kur mediat ia dalin të ekspozojnë një rast korrupsioni të nivelit të lartë, ato në përgjithësi marrin reagime shumë të kufizuara nga institucionet juridike dhe të zbatimit të ligjit, të cilat ose dështojnë t'i hetojnë rastet ashtu siç duhet, ose e bëjnë këtë vetëm sapo personi në fjalë të mos jetë më në pushtet. Kërcënimi dhe dhuna kundër aktivistëve dhe organizatave të shoqërisë civile janë, edhe këto, të dukshme, ku në pjesën më të madhe përfshihen avokues të drejtave të njeriut dhe aktivistë që hetojnë rastet e pretenduara të korrupsionit. Ka ende raste të ndërhyrjeve të jashtme në operimin e OSHC-ve, duke përfshirë fushatat njollosëse, që udhëhiqen nga media, dhe që kanë për qëllim t'ua dëmtojnë imazhin, arrestimin e aktivistëve dhe përpjekjen e dështuar për të krijuar një ligj për "agjentët e huaj", i cili do t'i vinte organizatat e shoqërisë civile që marrin përkrahje nga jashtë vendit nën një kontroll edhe më të madh të qeverisë²⁵.

Pak a shumë e njëjta gjë mund të thuhet edhe për **Maqedoninë**, ku shteti ushtron kontroll të fuqishëm mbi median përmes reklamave qeveritare të pakufizuara dhe të parregulluara. Më 1 korrik të vitit 2015, si rezultat i presionit ndërkombëtar, qeveria shpalli një moratorium për fushatat e reklamave qeveritare në kanalet mediatike kombëtare me anë të Marrëveshjes së Przino-s, ndonëse në kohën kur është shkruar ky raport, partitë politike nuk kishin arritur konsensus lidhur me ndryshimet ligjore në funksion të sigurimit të pajtueshmërisë me marrëveshjen. Një rast i fundit i ndërhyrjes politike në operacionet e medias është veçanërisht ilustrues. Duke iu referuar bashkëbisedimeve të përgjuara që u shfaqën për të vënë në dukje përfshirjen e figurave politike në aktivitete kriminale, korrupsion, përvetësim, mbulim vrasjesh, blerje votash dhe kundërvajtje të tjera të rënda, prokurori i shtetit nxori një deklaratë me të cilën e paralajmëronte median lidhur me pasojat e mundshme ligjore nga publikimi i informatave që do të mund të përdreshin si prova nga institucionet e drejtësisë penale. Kjo deklaratë u kritikua gjerësisht si një përpjekje për t'i zënë frymën lirisë së medias.

Një sfidë tjetër në Maqedoni është fakti që rregullatori mediatik, AAVMS nuk është as politikisht dhe as financiarisht i pavarur. Në të njëjtën kohë, shumica e gazetarëve nga media pro-qeveritare kanë rikrijuar Asosacionin Maqedonas të Gazetarëve (MAN). MAN-i është kritikuar për mbytyjen e pluralizmit dhe çdo kritike ndaj autoriteteve.

Politizimi i institucionit rregullator (Autoriteti i Medias Audio-Vizuale) dhe i transmetuesve publikë është tipar i kontrollit të qeverisë edhe në **Shqipëri**, dhe ka çuar në dështimin e tyre për t'i kryer përgjegjësitë e veta në mënyrë efektive. Edhe gazetarët shqiptarë janë përballur me presionin politik dhe kriminal, në formën e kërcënimeve dhe dhunës. Të paktën shtatë raste të tilla janë regjistruar publikisht gjatë dy viteve të fundit. Ndonëse ndonjëherë ofrohet mbrojtja e policisë dhe nisin hetime, nuk ka ndonjë njoftim për ndonjë ndjekje penale apo dënim. Akuzat kundër gazetarëve për shpifje janë të rralla, por janë vënë re deklarata armiqësore të politikanëve në drejtim të gazetarëve. OSHC-të në Maqedoni i nënshtrohen në të njëjtën mënyrë presionit politik, duke përfshirë shpifje të shpeshta dhe padi për shpifje. OSHC-të kanë qenë subjekt i dhunës dhe mos-tolerancës në vitet e fundit, duke përfshirë një sulm në një qendër të komunitetit LGBT dhe artikuj homofobikë në media. OSHC-të e financuara nga jashtë dhe që janë kritike ndaj qeverisë shpeshherë sulmohen në media si "tradhtarë" dhe "armike të shtetit".

E njëjta vlen edhe për **Malin e Zi**, ku gazetarët që hetojnë rastet e korrupsionit shpeshherë akuzohen për rrezikim të gjoja interesave kombëtare dhe damkosen nga zyrtarët e nivelit më të lartë të qeverisë si "tradhtarë të kombit". Sulmet dhe kërcënimet e shpeshta ndaj gazetarëve shërbejnë për të heshtur ata të cilët guxojnë të hetojnë problematikat e ndjeshme dhe të kritikojnë qeverinë apo grupe të tjera të fuqishme interesi, gjë që nxit me efektivitetin imponimin e vetë-censurës.

Në **Serbi**, ka një prirje në rritje të vetë-censurës dhe ndikime të panevojshme mbi politikën editoriale dhe faqet e internetit. Sipas Shoqatës së Gazetarëve të Pavarur të Serbisë, në vitin 2014 kundër gazetarëve ka pasur 22 sulme: 12 sulme fizike dhe dhjetë verbale²⁶. Rasti i sulmit më serioz ende mbetet për t'u zgjidhur. Ministri i Punëve të Brendshme pretendoi se gazetari i sulmuar nuk kishte arritur të njihete sulmuesit të paraqitur para tij në rresht, pavarësisht faktit se gazetari pretendonte se asnjëherë nuk i kishin kërkuar ta bënte këtë. Ndryshe nga kjo, OSHC-të në Serbi janë në përgjithësi të lira të veprojnë të pavarura nga qeveria. Megjithatë, ekzistojnë ende përpjekje nga qeveria dhe partitë politike për të kooptuar dhe manipuluar OSHC-të për qëllimet e tyre. OSHC-të që merren me çështje të ndjeshme, siç janë korrupsioni dhe abuzimi i fondeve publike, si dhe OSHC-të që operojnë në

25 Reuters, 2015, 'Bosnian Serb lawmakers withdraw "Putin's bill" as anti-European' [Ligjvënësit boshnjako-serbë tërheqin "Kartën e Putinit" si anti-evropiane], 19 maj <http://www.reuters.com/article/bosnia-law-ngo-idUSL5N0YA2FG20150519>

26 <http://inserbia.info/today/2014/12/nuns-22-attacks-on-journalists-in-serbia-this-year/>

nivel lokal, shpeshherë janë subjekt i sulmeve verbale, presionit dhe fushatave negative në mediat pro-qeveritare. Ka pasur raste të OSHC-ve të kapura, të cilat promovojnë interesat e qeverisë apo lançojnë fushata kundër organeve të pavarura apo OSHC-ve të tjera të cilat kritikojnë qeverinë. Një shembull i tillë është rasti ku dy organizata, të cilat iu bashkuan Ministrisë së Drejtësisë bënë fushatë kundër Agjencisë Kundër Korrupsionit, pas rekomandimit të kësaj të fundit se ministri duhej të hiqej nga detyra. Ndërkohë, zyrtarët e partive politike vazhdojnë të themelojnë OSHC-të e tyre me qëllim që të kenë qasje në fondet publike përmes edukimit ose trajnimit për anëtarët dhe zyrtarët e partisë. Disa anëtarë të shquar të OSHC-ve janë bërë pjesë e strukturave qeveritare, siç është udhëheqësi i një OSHC-je të njohur, e cila merret me zgjedhjet dhe financimin e partive, i cili ishte emëruar udhëheqës i Zyrës së Qeverisë për Rindërtimin dhe Lehtësimit nga Përmbytjet.

Kooptimi i OSHC-ve është i dukshëm edhe në **Shqipëri** dhe **Maqedoni**. Në rastin e kësaj të fundit, shembujt përfshijnë marrjen e posteve qeveritare apo politike nga drejtuesit e OSHC-ve, krijimin e OSHC-ve nga politikanë dhe përfshirjen e udhëheqësve të avokimit në strukturat qeveritare. Në Maqedoni, këto OSHC shihen si dora e shtrirë e qeverisë. Për shembull, shoqata e regjistruar së fundmi për Bashkimin Shpirtëror të Setinci-t, Popadinci-t dhe Krushodari-t nga Lerin-i nuk ka personel, fonde apo faqe interneti, por pavarësisht kësaj dhuron monumente me vlerë prej miliona eurosh.

Situata në **Turqi** është veçanërisht kritike. Ekziston një shqetësim serioz lidhur me Ligjin Kundër Terrorit dhe Kodin Penal të Turqisë, të cilët janë përdorur vazhdimisht për të censuruar dhe ndjekur penalisht gazetarë. Freedom House dhe Komisioni për Mbrojtjen e Gazetarëve e kanë etiketuar Turqinë si kryeburgosësen e gazetarëve në botë, e ndjekur ngushtësisht nga Irani dhe Kina. Veprimet e qeverisë për të shtypur lirinë e fjalës u shtuan pas një skandali të madh korrupsioni në dhjetor të vitit 2013 dhe janë intensifikuar më tej që prej grushtit të dështuar të shtetit të korrikut të vitit 2016. Një numër gazetarësh që hetuan dhe raportuan lidhur me detajet e rasteve të korrupsionit të datave 17 dhe 25 dhjetor të vitit 2013 është dënua që prej atëherë. Deri në vitin 2015, ka pasur 120 raste në proces kundër 70 gazetarëve të cilët mbuluan skandalin. Sërish, në dhjetor të vitit 2014, u arrestuan 31 njerëz, duke përfshirë gazetarë dhe producentë televizivë, të njohur për afërsitë e tyre me klerikun mysliman me vendqëndrim në Shtetet e Bashkuara, Fethullah Gylen. Sipas Shoqatës së Gazetarëve Turq, 1,037 gazetarë janë pushuar nga puna gjatë gjysmës së parë të vitit 2014, për shkak të mbulimit të rasteve të korrupsionit. Para pak kohësh, sipas Amnesty International, autoritetet turke bllokuan arbitrarisht qasjen në më shumë sesa 20 faqe lajmesh në internet gjatë ditëve pas grushtit të

TURQI: PROTESTA CIVILE VAZHDON TË EKZISTOJË PAVARËSISHT RITJES SË PRESIONIT

Pavarësisht përshkallëzimit të represioneve ndaj shoqërisë civile në Turqi, ose ndoshta për shkak të kësaj, Fondacioni i Sektorit të Tretë (TUSEV) sugjeron se qytetarët e Turqisë janë duke kaluar nga protestat e nivelit të lartë në angazhime alternative e të qëndrueshme. Që prej protestave të Parkut të Gezit në vitin 2013, janë shfaqur forma të reja të mobilizimit për të baraspeshuar dhe sfiduar pushtetin. Në të gjithë Turqinë, pas protestave të Gezit, janë themeluar këshilla lokale në lagje, të cilët forcojnë rezistencën në lagje dhe ofrojnë shembuj të gjallë të demokracisë së drejtpërdrejtë²⁸.

dështuar të shtetit të korrikut të vitit 2016 dhe qeveria hoqi licencat e 25 mediave në vend. Krahas kësaj, 34 gazetarëve individualë iu janë anuluar kartat e shtypit dhe të paktën një gazetarëje iu lëshua një fletë-arrest për shkak se kishte mbuluar grushtin e dështuar të shtetit . Nuk është për t'u habitur, në këtë kontekst, që shumë gazetarë praktikojnë vetë-censurë me qëllim që të shmangin këqyrjet dhe masat ndëshkimore nga qeveria. OSHC-të në Turqi vuajnë nga e njëjta shtypje, duke përfshirë aplikimin arbitrar të ligjit, trajtimin e pabarabartë dhe auditimet e shpeshta dhe gjithëpërfshirëse nga autoritetet, sidomos kundër atyre që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut. Njëlloj si në rastin e medias, interpretimet e aktiviteteve të shoqërisë civile duke u mbështetur në Ligjin Kundër Terrorit shpeshherë e pengojnë lirinë e fjalës dhe shoqërimin dhe shpesh çojnë në dënime të rënda me burg dhe periudha paraburgimi gjatë procedurave paraprake. Edhe konceptet e “moralitetit të përgjithshëm”, “strukturës së familjes turke”, “sigurisë kombëtare” dhe “rendit publik” përdoren gjerësisht për të penguar lirinë e shprehjes dhe shoqërimin.

27 Amnesty International, 2016, 'Turkey: Media purge threatens freedom of expression' [Turqia: Spastrimi i medias kërcënon lirinë e fjalës], 20 korrik <https://www.amnesty.org/en/latest/news/2016/07/turkey-media-purge-threatens-freedom-of-expression/>

ANEKSI: REKOMANDIME SPECIFIKE SIPAS VENDEVE



Drejtësia dhe sistemi i zbatimit të ligjit

- **Të zvogëlohet ndikimi i ekzekutivit mbi gjyqësorin dhe prokuroritë duke siguruar sisteme më objektive, transparente dhe meritore për emërimin, transferimin dhe largimin nga puna të gjyqtarëve dhe prokurorëve.**

Turqia: Qeveria duhet ta transferojë përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga Ministria e Drejtësisë të HSYK dhe t'u japë fund ndërhyrjeve në punën e prokurorëve, duke përfshirë kërcënimin, pengimin, ngacmimin, ndërhyrjet e pavenda apo ekspozimin e pajustificuar ndaj detyrimeve civile, penale apo detyrimeve të tjera.

Maqedonia: Këshilli Gjyqësor duhet të sigurojë zbatimin e plotë të parimit të emërimit dhe ngritjes në detyrë të gjyqtarëve mbi bazën e meritave, me qëllim që të fuqizohet pavarësia, paanshmëria dhe integriteti i gjyqësorit.

Mali i Zi: Gjyqësori duhet të publikojë vendime për përzgjedhjen dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve, duke u mbështetur në kritere të qarta dhe të detajuara.

Serbia: Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të zbatojë procedurat për vlerësimin e gjyqtarëve dhe të kryejë procedurat për krijimin e llogaridhënies për gjyqtarë për lëshime në punën e tyre, duke vënë në pah gjatësinë e procedurave, mungesën e njohurive lidhur me ligjin apo sjelljen jo-profesionale.

Shqipëria: Partitë politike në kuvend duhet të miratojnë reformën e drejtësisë përmes konsensusit të gjerë mbarë-partiak, duke siguruar, inter alia, pavarësinë e duhur dhe llogaridhënien për institucionet gjyqësore dhe prokurorinë.

- **Të kufizohen kompetencat diskrecionale të kryeprokurorit dhe të rritet kapaciteti i prokurorëve për të menaxhuar raste komplekse të korrupsionit.**

Turqia: Prokuroria duhet ta kufizojë autoritetin që kanë kryeprokurorët publikë mbi prokurorët publikë. Praktika e miratimit dhe rishpërndarjes së rasteve, e cila është në diskrecionin e vetëm të kryeprokurorëve publikë, do të duhet të braktiset.

B&H: Duhet të krijohen mekanizmat për monitorimin e kompetencave të pakufizuara diskrecionale të prokurorëve për të nisur/pushuar hetimet. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial i B&H duhet të fuqizojë kapacitetin e prokurorëve për kryerjen e hetimeve komplekse financiare dhe të përmirësojë koordinimin me policinë në nivele të ndryshme të qeverisë.

Serbia: Këshilli Prokurorial i Shtetit dhe prokuroritë duhet të rrisin numrin e prokurorëve të cilët merren me hetimin e rasteve të korrupsionit, me qëllim që të kryejnë hetime proaktive mbi bazën e modeleve të identifikuara të sjelljes korruptuese, e cila mund të jetë e supozuar apo për të cilën ka shenja se ndodh diku tjetër.

- **Të zvogëlohet politizimi dhe të fuqizohet profesionalizimi i policisë, edhe përmes zbatimit të sanksioneve të rrepta mbi anëtarët e forcave policore, të cilët përfshihen në veprimtari politike gjatë kryerjes së detyrave të tyre.**

Maqedonia: Ministria e Brendshme duhet të krijojë mekanizma efektivë, duke përfshirë mekanizmat e bilbil-fryrjes (whistleblowing) për të parandaluar aktivitetet politike në ambientet e policisë. Kjo është e domosdoshme për të përfunduar aftësinë e zyrtarëve për t'i rezistuar ndikimit politik të panevojshëm dhe aftësinë e tyre për t'i rezistuar instrumentalizimit gjatë zgjedhjeve apo mitingjeve politike, si mjete në duart e partive politike.

Mali i Zi: Duhet të zbatohen sanksione të rrepta për stafin e Drejtorisë së Policisë, të cilët abuzojnë ose i lënë pas dore detyrat e tyre apo që angazhohen në veprimtari të partive politike. Prezantimi i një mekanizmi të brendshëm të bilbil-fryrjes (whistleblowing) do të ndihmonte edhe në identifikimin e sjelljes së keqe.

Shqipëria: Komisioni parlamentar shumë-partiak për hetime për policinë duhet të bjerë dakord dhe të publikojë një kalendar pune dhe ndoshta një raport tërësor lidhur me vendimet për karrierë dhe shkarkime nga detyra në Polici, të shoqëruar me rekomandime për rrugën përpara. Në fund të këtij procesi duhet të merret parasysh marrja e një vendimi nga Kuvendi, me të cilin palët të angazhohen për qëndrueshmëri dhe profesionalizëm në Polici.

- **Të forcohet dukshëm bashkëpunimi midis organeve përgjegjëse për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit dhe të përmirësohet cilësia dhe ndarja e informatave dhe të dhënave lidhur me ndjekjen penale të kundërvajtjeve të korrupsionit.**

Turqia: Mangësitë në koordinimin dhe bashkëpunimin midis inspektorateve duhet të mënjanohej përmes formimit të një kornize rregullatore kundër korrupsionit.

Kosova: Kuvendi i Kosovës duhet të shqyrtojë kompetencën ligj-zbatuese / hetuese të AKK-së, pasi të jetë kryer një shqyrtim i përgjithshëm i aranzhimit institucional të mekanizmave të vendit kundër korrupsionit.

B&H: Prokuroritë dhe policia në nivele të ndryshme ekzekutivi duhet të forcojnë bashkëpunimin, sidomos në aspektin e dokumentimit të krimeve që kanë të bëjnë me korrupsionin.

B&H: Qeveria duhet të forcojë bashkëpunimin me të gjitha institucionet që kanë mandat për luftën kundër korrupsionit, si dhe bashkëpunimin me institucionet për përgatitjen, zbatimin dhe monitorimin e planeve të integritetit.

Serbia: Qeveria dhe Ministria e Brendshme duhet të krijojnë njësinë anti-korrupsion, të parashikuar nga Strategjia Kombëtare Kundër Korrupsionit dhe të qartësojë pozicionin e SBPOK-ut (Shërbimi për Luftën kundër Krimit të Organizuar) dhe marrëdhëniet e tij me njësinë e re.

- **Të minimizohen vonesat në rastet e korrupsionit, të ofrohen arsye të qarta për vendimet për mos-ndjekje penale dhe të zgjatet parashkrimi për krimet që kanë të bëjnë me korrupsionin.**

Mali i Zi: Gjyqësori duhet të publikojë të gjitha marrëveshjet për pranimin e fajësisë, vendimet për shtyrjen e procedurave penale dhe vendimet për hedhjen poshtë të akuzave penale.

Serbia: Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe gjykatat duhet të kryejnë një analizë të procedurave në rastet e pretendimeve për krimet e korrupsionit, të cilat zgjasin shumë, dhe të paraqesin para publikut arsyet për këto vonesa.

Shqipëria: Inspektorati Gjyqësor duhet të kryejë një inspektim tematik të gjykimeve të rasteve të korrupsionit, e cila do të shërbejë si baza e parë për përmirësimin e praktikës gjyqësore në këtë sferë.



Sistemi politik

- **Të përmirësohet në mënyrë të konsiderueshme transparenca e partive politike, duke përfshirë auditimin e rregullt dhe gjithëpërfshirës të financave të partive.**

Kosova: KQZ duhet të priorizojë auditimin e jashtëm të financave të partive.

Turqia: Financat për fushatat e të gjithë kandidatëve për zgjedhjet lokale, parlamentare apo presidenciale duhet të rregullohen dhe t'i nënshtrohen auditimit.

B&H: Ligji për Financimin e Partive Politike duhet të njohë detyrimin që partitë politike të mos përdorin llogari të shumëfishta bankare, por vetëm një, për të gjitha transaksionet e tyre financiare. Krahas kësaj, ligji duhet të prezantojë edhe auditimin e shpenzimeve të partive (dhe jo vetëm të të ardhurave), për të siguruar kontrollin efektiv të tyre. Formularët për raportet financiare duhet të jenë më të detajuara me qëllim që të përfshihen informata për të gjitha shpenzimet.

Shqipëria: Partitë politike duhet të publikojnë në mënyrë proaktive biografite e plota të kandidatëve në zgjedhje, si dhe të dhëna për fondet dhe shpenzimet, në intervale të rregullta gjatë fushatës zgjedhore të ardhshme të vitit 2017 dhe përpara ditës së zgjedhjeve.

- **Të zhvillohet mbikëqyrja më e fuqishme dhe më e koordinuar e veprimtarive të partive politike dhe fushatave dhe të sigurohet që shkelja e rregulloreve të zgjedhjeve dhe të fushatave të ndëshkohet në mënyrë konsistente.**

B&H: Ligji duhet të zgjerojë gamën e ndëshkimeve që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në vend mund të caktojë për partitë politike dhe kandidatët (siç janë mohimi i financimit buxhetor për partitë që i shkelin vazhdimisht rregullat).

Serbia: Qeveria duhet të propozojë dhe parlamenti të miratojë ndryshime në Ligjin për Financimin e Aktiviteteve Politike, sikurse parashihet nga Strategjia Kombëtare Kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimit, me qëllim që të përcaktohen dhe ndahen qartë përgjegjësitë e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Institucionit të Auditimit të Shtetit dhe institucioneve të tjera në procesin e kontrollimit të aktiviteteve politike dhe subjekteve politike, dhe me qëllim që të përcaktohen me saktësi detyrimet dhe mekanizmat për financimin transparent të subjekteve politike.

- **Të zbatohen ndëshkime të rrepta për shpërdorimin e burimeve publike për fushata zgjedhore.**

B&H: Ligji për Financimin e Partive Politike duhet të përfshijë kufizime të detajuara lidhur me përdorimin e posteve publike dhe burimeve institucionale për qëllime të promovimit të kandidatëve dhe partive përpara zgjedhjeve.

Serbia dhe Mali i Zi: Të dyja qeveritë duhet të propozojnë dhe të dyja kuvendet duhet të miratojnë ndryshime ligjore për rregullimin e keqpërdorimit të posteve nga zyrtarët publikë për të promovuar partitë e tyre në fushatat zgjedhore.

- **Të sigurohet integriteti i atyre që garojnë për poste publike.**

Kosova: Partitë politike duhet të promovojnë një kulturë më demokratike përmes prezantimit të udhëzuesve me të cilët kërkohet që politikanët për të cilët janë ngritur aktakuza të heqin dorë nga partia e tyre politike dhe nga çdo pozitë tjetër që mbajnë.

Shqipëria: Partitë politike duhet të krijojnë mekanizma të ashpra kontrolli lidhur me të shkuarën e kandidatëve të zgjedhjeve, të prezantojnë kriteret e përzgjedhjes për kandidatët në zgjedhje, të cilat i japin peshë njohjes nga publiku, shërbimit për komunitetin dhe arritjeve të shquara profesionale, dhe të bëhet kombinimi i formimi profesional dhe gjendjes financiare të tyre, me qëllim që të kundërshtohet prirja në rritje e zënies së posteve nga biznesmenë. Ato duhet të përfshijnë komunitetet dhe strukturat e partisë në përzgjedhjen e kandidatëve.



Media dhe shoqëria civile

- **Të gjitha vendet duhet të hetojnë në mënyrë aktive të gjitha pretendimet për kërcënime dhe dhunë ndaj përfaqësuesve të medias dhe të shoqërisë civile dhe të zbatojnë dënime të rrepta kur provohet se këto pretendime janë të bazuara.**

- **Të sigurohet transparencë e plotë në aspektin e përgjegjësisë dhe funksionimit të medias dhe organizatave të shoqërisë civile.**

Turqia: Të sigurohet transparenca dhe të eliminohet vetë-censurimi, strukturat e pronësisë së medias duhet të rregullohen nga një Këshill i pavarur i Lartë i Radios dhe i Televizionit (RTÜK) dhe të publikohen bizneset e tjera të pronarëve të medias.

Serbia: Parlamenti duhet të ndryshojë Ligjin për Informimin Publik dhe Mediat me qëllim që t'iu kërkojë mediave të publikojnë të dhënat për financiarët dhe reklamuesit kryesorë.

- **Të sigurohet gara e drejtë dhe fusha e lojës e medias dhe organizatave të shoqërisë civile.**

Turqia: Korniza ligjore që rregullon përjashtimet nga taksat dhe arkëtimet e donacioneve duhet të shqyrtohet për të eliminuar pabarazitë dhe për të krijuar një mjedis lehtësues për shoqërinë civile. Statusi për përfitimeve publike, i cili iu jepet shoqatave dhe fondacioneve, duhet të përkufizohet objektivisht, ndërkohë që dhënia e statusit për përfitime publike do të duhet të mos ndikohet nga politika.

Maqedonia: Qeveria duhet të ndryshojë Ligjin për Mediat dhe të sigurojë që reklamat politike të mos lejohen në shërbimet mediatike publike, dhe të rregullohen me licenca kombëtare.

B&H: Për të siguruar trajtim të barabartë për të gjitha mediat në treg, qeveria duhet të sigurojë procedura transparente dhe konkurrense për alokimin e subvencioneve shtetërore dhe të krijojë rregulla transparente për reklamimin në media, me qëllim që të përmirësohet pavarësia dhe konkurrenca mediatike.

Mali i Zi: Qeveria duhet të alokojë fonde organizatave jo-qeveritare nga buxheti i shtetit përmes një konkursi publik, duke përcaktuar kriteret të qarta dhe objektive dhe duke detajuar mënyrën se si përmbushen këto kriteret, si dhe të krijojë mekanizmat për mbikëqyrjen e zbatimit të projekteve të financuara.

- **Të sigurohet rregullimi dhe mbikëqyrja efektive dhe apolitike e medias dhe organizatave të shoqërisë civile.**

Turqia: Duhet të sigurohet autonomia administrative dhe neutraliteti politik i Këshillit Suprem të Radios dhe Televizionit, ndërkohë që dispozitat për lirinë e shprehjes duhet të fuqizohen për të siguruar pavarësinë editoriale.

B&H: Qeveria duhet të sigurojë zgjedhje të pavarura të anëtarëve të bordeve menaxhuese në transmetuesit publikë, përmes procedurave publike dhe konkurruese.

B&H: Qeveria duhet të përcaktojë më tej procedurat për regjistrimin e OSHC-ve, me qëllim që të bëjë që ato të mos jenë pronësi apo të mos manipulohen nga individët në pushtet.

Transparency International
International Secretariat
Alt-Moabit 96
10559 Berlin
Germany
Phone: +49 - 30 - 34 38 200
Fax: +49 - 30 - 34 70 39 12
ti@transparency.org
www.transparency.org
blog.transparency.org
[facebook.com/transparencyinternational](https://www.facebook.com/transparencyinternational)
twitter.com/anticorruption